



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 390 Akti

Nr. 402 Vendimi
Tiranë, më 24.5.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Roland Ilia	Relator
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 20.5.2021, ora 13:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Erjon Bani**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit

kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Bani, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Bani, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin më 16.12.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Bani, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Roland Ilia dhe Etleda Çiftja.

4. Për këtë subjekt rivlerësimi u caktua me mirëkuptim kryesues i trupit gjykues, komisionere Pamela Qirko, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Bani.

5. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Bani, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht, në nenin 30 të këtij ligji, kishte për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

8. Në përputhje me nenet 30-33 të ligjit nr. 84/2016 u administrua shkresa me nr. *** prot., datë 14.11.2018, e ILDKPKI-së, që ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit Erjon Bani, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

9. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka

dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2017 (deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 5.5.2021, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë e vazhdimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Bani.

10. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në të dhënat e rezultuara nga tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti, pesë dokumenteve ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, të dhënat arkivore të KLGJ-së, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 18.9.2020, për subjektin e rivlerësimit, ardhur në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 6.10.2020.

11. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për të tria kriteret e vlerësimit: të pasurisë, të kontrollit të figurës, si dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

12. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë së figurës dhe vlerësimin profesional, në datën 11.5.2021 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Bani; (ii) njoftimin e subjektit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 11.5.2021 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti u njoh me aktet e dosjes në datën 12.5.2021 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më 17.5.2021.

14. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me dosjen dhe ka marrë një kopje të saj, ka dërguar shpjegimet në rrugë zyrtare. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim shpjegimet e paraqitura dhe provat mbështetëse mbi rezultatet e hetimit në datën 18.5.2021, vendosi të ftojë z. Erjon Bani në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

II. SEANCA DËGJIMORE

15. Subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Bani, u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 18.5.2021.

16. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 20.5.2021, ora 13:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar.

17. Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Bani, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Z. Erjon Bani ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

20. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

20.1 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

20.2 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

20.3 Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohet objekti i rivlerësimit të aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

21. Referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;

¹“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

- c) “Deklarata e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*” dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- dh) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë, referuar neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016 dhe me shkresën nr. *** prot., datë 14.11.2018, ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Erjon Bani, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me këtë subjekt të rivlerësimit, ka konstatuar se:

- a. *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b. *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c. *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d. *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Z. Erjon Bani është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2012, me nr. indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, si vijon:

- deklaratën para fillimit të detyrës, viti 2012;
- deklaratën periodike vjetore për vitet 2013 – 2016;
- deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, për efekt të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti i rivlerësimit, në periudhën tetori 2012 – janar 2014 ka kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në janar të vitit 2014 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në nëntor të vitit 2016 është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vazhdon edhe aktualisht detyrën si gjyqtar.

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) deklaramet e subjektit me anë të komunikimit elektronik;

d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit.

Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklarimeve të interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë te ky institucion, duke i krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Bani, pas:

- a) shqyrtimit të të dhënave të “Deklaratës së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”, me nr. indeksi ***, datë 21.10.2016, për subjektin e rivlerësimit;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhën 2012 – 2016, në raport me të dhënat në “Deklaratën e rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje *cash*;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni.

Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Bani, ka deklaruar pasuritë si vijon:

1. Apartament në përdorim, Tiranë

1.1 Subjekti në deklaratën *vetting* ka deklaruar se: [...] *Banoj në banesën e prindërve, së bashku me bashkëshorten A.B. dhe djalin tim A.B. në një apartament, me sipërfaqe 113.79 m², shkalla ***, kati i ***, apartamenti ***, që ndodhet në Njësinë Administrative Nr. ***, Rruga “****”, ***, Bashkia Tiranë, i cili është fituar nga shtetasi J.B.B. (babai i deklaruësit) me Kontratën e Shkëmbimit (Me kusht) datë 27.11.2015 të lidhur përpara noterës V.S. Kjo pronë nuk është regjistruar në ZVRPP Tiranë. Për rrjedhojë banimi në këtë banesë nga deklaruësi nuk bazohet në ndonjë akt noterial sikurse e kërkojnë nenet 143, 144, 193 pika “b”, 195, 235, 259 dhe 260 të Kodit Civil. Bashkëlidhur dokumentacioni provues. Mbi këtë banesë nuk kemi asnjë të drejtë pronësie apo të drejtë reale me ndonjë akti noterial.”.*

1.2 Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion provues, lidhur me pasuritë e babait ku rezultoi se:

- a. Me anë të kontratës së shitblerje Nr. *** Rep., dhe Nr. *** Kol., datë 30.07.1996, pala shitëse Këshilli i Rrethit Sarandë i ka shitur R. (babai i subjektit), truallin me sip. 690 m², që ndodhet në lagjen nr. ***, Sarandë, në vlerën 331.200 lekë, paguar me mandat arkëtimi nr.***, datë 29.7.1996.

Për këtë pasuri truall është lidhur kontratë sipërmarrje Nr. *** Rep., dhe Nr. *** Kol., datë 16.04.2009, me palë pronare truall J.B., (ndryshuar emri nga R. në J.) dhe pala sipërmarrëse shoqëria “****” shpk, kanë rënë dakort që J.B. të verë në dispozicion truallin me sip. 690 m², në Sarandë në ZK. ***, për ndërtim e një objekti, banesë shumëkatëshe duke përfituruar 26% të sipërfaqes së ndërtimit, e cila do të ndërtohet nga sipërmarrësi. Për të përcaktuar në natyrë të pronarit të truallit, midis shetasit J.B. dhe sipërmarrësit dhe investitorit shoqërisë “****” sh.p.k është lidhur Kontrata “Për përcaktimin në natyrë të pjesës së pronarit të truallit në objekt” më Nr. *** Rep., dhe Nr. *** Kol., datë 10.10.2009.

Me anë të kontratës së shkëmbimit nr. Nr. *** Rep., dhe Nr. *** Kol., datë 29.10.2012, me palë pronar truall J.B. dhe palë investuese shoqëria “****” shpk, ka

përcaktuar që palët bien dakord të shkëmbejnë sip. 690 m², që ndodhet në emër të J.B. me shoqërinë ndërtuese “****” shpk, e cila do të ndërtojë objektin shumëkatësh, duke përfutur pjesë në natyrë në këtë objekt, si më poshtë: **Garazh nr. ****, me sip. 28 m². Garazh nr. ****, me sip. 28 m². Garazh, nr. **** me sip.28 m². Garazh nr.****, me sip. 28 m². Apartamente si më poshtë: Apartament banimi nr. **** me sip.76m²; Apartament banimi nr. ****, me sip. 80 m²; Apartament banimi nr. **** me sip. 56 m²; Apartament banimi nr. **** me sip. 79 m²; Dyqan **** me sip. 32 m². Dyqan ****, me sip. 173 m²; Apartament banimi nr. ****, me sip. 76 m²; Apartament banimi nr. **** me sip.76 m²; Apartament banimi nr. ****, me sip.79m².**

- b. Me anë të kontratës së shkëmbimit (me kusht) Nr. **** Rep., dhe Nr. **** Kol., 03.5.2012, kanë rënë dakord që pala e parë J.B. të shkëmbejë pasurinë e tij apartament **** **me sip. 76 m²** ndodhur në Lagjen nr. **** Sarandë, me nr. pasurie **** me palën e dytë, znj. E.M., apartamentin nr. ****, kati i pestë i banimit me sip.77.15 m².

Në datë 9.8.2014, palët bien dakord të zgjidhin këtë kontratë shkëmbimi, për të mundësuar redaktimin e një kontratë shkëmbimi të re me Nr. **** Rep., dhe Nr. **** Kol., datë 09.8.2014. Pala e parë J.B., ka në pronësi të tij, apartamentet ****, **me sip.76 m²**, ndodhur në Sarandë, lagja nr. ****, ZK ****, me nr.pas. ****. Pala e dytë E.M. ka porositur me kontratë porosie nr. ****, dt. 06.11.2009, pasi ka likuiduar plotësisht çmimin e një apartamenti nr. ****, me sip. 77.15 m², në Tiranë. Palët bien dakord, të shkëmbejnë këto pasuri, dhe znj.E.M., t'i paguajë z. J.B., vlerën 8.000 euro, si kompensim për njësimin e vlerës së pronave. Shkëmbimi dhe regjistrimi i pronave në ZVRPP, do të bëhet pasi znj.E.M., të pajiset me çertifikatë pronësie. Pra, është lidhur një kontratë shkëmbimi me kusht pezullues.

- c. Bazuar në kontratën e shkëmbimit me kusht Nr. **** Rep dhe Nr. **** Kol., datë 27.11.2015, me palë të parë J.B. dhe palë të dytë H.M., (me qëllim shkëmbimin e apartamenteve), pala e parë J.B. shkëmben apartamentin nr. ****, kati i **** banimi, me sip. 77.15 m², i mobiluar dhe punime bashkëkohore i cili ndodhet në Rr. “****”, **** Tiranë me palën e dytë H.M., ka në pronësi të tij apartamentin 2+1 me sip. 113.79 m² shkalla e 3-të, kati i pestë, në rrugën “****” i pa mobiluar. Si kompensim për njësimin e vlerës së pronave të shkëmbyera, palët bien dakord që të shërbejnë vlera e mobilimit dhe e punimeve bashkëkohore.

Me anë të deklaratës noteriale Nr. **** Rep., dhe Nr. **** Kol., datë 11.10.2016, shtetasi J.B. ka deklaruar se ndërmjet kontratës së shkëmbimit datë 27.11.2015, ka përfutur apartamentin e shtetasit H.M., por që figuron si pasuri e paregjistruar në ZVRPP Tiranë. Në këtë banesë, banon djali i tij Erjon Bani së bashku me familjen e tij.

1.3 Pranë ILDKPKI, subjekti ka deklaruar dhe sqaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie që e ka në përdorim, njësoj sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit.

1.4 Në deklaratat e interesave private ndër vite (2012-2017), subjekti ka deklaruar disa adresa të ndryshme për pasuri të paluajtshme.

1.5 Është pyetur subjekti në lidhje me:

² Kjo është sipërfaqja e regjistrueshme në hipotek, pasi sipërfaqja e përgjithshme e ndërtimit për këtë apartament sipas planimetrisë është **103 m²**.

- raportin e tij me pasuritë e paluajtshme të deklaruara ndër vite në DPV, përdorimin e tyre me ose pa kundërshpërblim dhe mosdeklarimin e këtyre pasurive që ka pasur në përdorim në deklaratën vetting.

- pse ka deklaruar pasuri në përdorim “Apartament, me sipërfaqe 113.79 m², shkalla ***, kati i ***, apartamenti ***, që ndodhet në Njësinë Administrative Nr. ***, Rruga “****”, ***, Bashkia Tiranë”, i cili është fituar nga shtetasi J.B.B. (babai i deklaruesit) me Kontratën e Shkëmbimit (Me kusht) me Nr. *** Rep., dhe Nr. *** Kol., datë 27.11.2015. Bazuar në kontratën e shkëmbimit datë 27.11.2005 J.B. ka përfituar pasuri “Apartament 2+1 me sip.113.79 m², shkalla *** kati i *** apartamenti ***, i cili ndodhet në rr. “****” Tiranë”.

- të vërë në dispozicion të Komisionit dokumentacion provues lidhur me përfitimin e pasurisë që kanë përdorim dhe të deklarojë burimin e ligjshëm të përfitimit të kësaj pasurie në përdorim.

-të saktësohet mundësia financiare e prindërve dhe të sqarohet nga subjekti si një pronë e blerë në vlerën 35,800 euro (apartament me sip. 77.15 m², rruga “****” *** Tiranë) shkëmbehet me nje pronë tjetër me vlerën shumë më të madhe prej 53,000 euro (apartament me sip.113.79 m², rruga “****” Tiranë).

1.6 Subjekti në përgjigje të pyetsorit nr.2 ka deklaruar:

*[...] Kam jetuar me qira në Rrugën “****”, (Përballë Shkollës ***), shtëpia Nr. ***, kati ***, Njësia Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, nga fillimi detyrës (10.10.2012) deri në javën e parë të muajit Maj 2013. Vlera e qirasë ka qenë 18.000 lekë në muaj. Qiranë jam kam paguar shtetases J.M.B., e cila ishte personit i vetëm që banonte, në katin e parë të shtëpisë private, pasi sikurse ajo ka deklaruar prindërit i ka pasur jashtë shtetit, konkretisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nuk kemi lidhur kontratë me shkrim. Për të provuar ekzistencën e marrëdhënies juridike që rrjedhë nga qiraja po paraqes në cilësinë e provës komunikimin me email me shtetasen J.M.B. e cila ndodhet në SHBA. [...]*

*-Kam jetuar pa qira në Rrugën “****”, apartamenti Nr. ***, kati ***, Njësia Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, nga muaji Maj 2013 deri në muajin Nëntor 2015. Kjo është pasuri e përfituar me anë të shkëmbimit nga babai im shtetasi J.B. më datë 03 Maj 2013 me shtetasen E.D.M.. Me Kontratën e Shkëmbimit datë 09 Gusht 2014 midis babait tim shtetasit J.B. dhe shtetases E.D.M. është vendosur rishikim të interesave të tyre, duke mundësuar redaktimin e një Kontrate Shkëmbimi të re. Palët deklarojnë se kalimi i të drejtës së pronësisë për pasuritë e shkëmbyera, do të bëhet vetëm pasi Znj. E.M. do të pajiset me çertifikatë pronësie për apartamentin Nr. ****..”.[...]*

*- Jetoj pa qira në Rrugën “****”, pallati Nr. ***, apartamenti Nr. ***, kati ***, Njësia Administrative Nr. ***, Bashkia Tiranë, nga muaji Nëntor 2015. Kjo pasuri është përfituar nga im atë shtetasi J.B., me Kontratën e Shkëmbimit të datës 09 Gusht 2014 me shtetasin H.M.[...]*

*- Kam qenë i regjistruar në Zyrën e Gjendjes Civile në adresën: Rruga “****”, Pallati ***, Ap, ***, Njësia Administrative Nr. *** Tiranë, Bashkia Tiranë, nuk kam banuar kurrë në këtë adresë, e cila është banesa në pronësi të prindërve të bashkëshortes, e ku ajo ka pasur vendbanimin para lidhjes së martesës. Pra, kjo pronë është fituar dhe likjuar rreth tri vite më parë se unë të filloja detyrën si gjyqtar (10.10.2012) dhe dy vite më parë se unë të bashkëjetoja e të lidhja martesë me bashkëshorten time (14.05.2012). Kjo adresë është regjistruar për efekt të celebrimit të martesës më datë 14.05.2012 sipas Kodit të Familjes.[...]*

*- Burim i burimit të krijimit të çdo pasurie që është në pronësi të prindërve të mijë apo që mund të fitojnë në të ardhmen nëse vërtetohet kushtit pezullues,³ ku bën pjesë dhe apartamenti me adresë: Rruga “****” Pall.***, shkalla ***, kati ***, ap.***, *** Tiranë, është shkëmbimi i truallit prej 690 (gjashtëqin e nëntëdhjetë) m², që ndodhet në qytetin e Sarandës, Lagjia Nr. ***, Pasuria me Nr. ***, Zona Kadastrale ***, i cili është blerë nga babai im me Kontratën e Shitblerjes me Nr. *** Rep., dhe Nr. *** Kol., datë 30.07.1996, kur unë kam qenë 11 vjeç.[...]*

*- Apartamentin me adresë: Rruga “****” Pall.***, shkalla ***, kati ***, ap.***, *** Tiranë, është ndërtuar në vitin 2003, pra një pallat 17 vjeçar, për rrjedhojë një godinë me ambiente të përbashkëta shumë të amortizuara. Apartamenti ishte i pa mobiluar. Gjithashtu, cilësia e punimeve është me një diferencë të dukshme me cilësinë e punimeve në godinën, ku ndodhet apartamenti me adresë: Rruga “****” Pall. *** ap.***, kati i *** i banimit, *** Tiranë. Pra, cilësia e punimeve të godinës ku ndodhet ky i fundit është shumë më e mirë pasi është një godinë me e re, mjafton që të shikohen fotot e të dy objekteve që do të bashkëlidhen kësaj deklarate. Sipas deklaramit të babait tim, shtetasi H.M. kishte interes për një apartament të mobiluar që do t’ia lehtësonte dhënien me qera, pasi kërkesat që ka pasur për dhënien me qera kanë qenë për apartamente të mobiluar. Kjo bëri që të përputheshin interesat e dy palëve për të hyrë në një marrëdhënie juridike civile sikurse është ajo që rrjedhë nga Kontrata e Shkëmbimit.*

*- Lidhur me nivelin e të ardhurave, babai im J.B. deklaroi se sikurse e ka theksuar në Deklaratën Noteriale me Nr. *** Rep., dhe Nr. *** Kol., datë 19.02.2020⁴ niveli i të ardhurave të tij vetëm nga shitja e tre apartamenteve dhe një garazhi ka qenë rreth 150 mijë Euro, të mjaftueshme për ta blerë tre herë apartamentin e shtetasit H.M. me adresë: Rruga “****” Pall.***, shkalla ***, kati ***, ap.***, *** Tiranë. Por vullneti real i palëve ka qenë thjesht shkëmbimi i dy apartamenteve që nga njëra anë shtetasi H.M. merrte një apartament të mobiluar dhe me punime cilësore e bashkëkohore nga ana tjetër babait im J.B. merrte një apartament me një sipërfaqe më të madhe.[....]*

1.6.1. Në shpjegimet lidhur me raportin e interesit me pronarët apo titullarët e pasurive të paluajtshme të deklaruara në DPV ndër vite, si adresa banimi, subjekti i rivlerësimit, duke u mbështetur në vendimet Nr. 15, datë 17.07.2019; Nr. 7, datë 24.06.2020; Nr. 8, datë 25.06.2020; Nr. 10, datë 08.09.2020 dhe Nr. 21, datë 10.09.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ka deklaruar se, [....]

12. Sa më sipër u sqarua, deklaroj unë dhe personat e lidhur me mua (bashkëshortja e fëmijët) gjatë periudhës së deklaramit nuk ndodhemi në kushtet e një marrëdhënie dhurimi apo huaje me ndonjë person fizik apo juridik, për rrjedhojë nuk ndodhem në kushtet e një interesi pasuror në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 në raport me personat që janë pronar apo titullarë të banesave, ku unë kam qëndruar gjatë periudhës së rivlerësimit e që janë deklaruar si adresa banimi nga ana ime. Për këtë arsye, nuk mund të konsiderohen “person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit”. Megjithatë, sikurse citohet më lartë gjatë periudhës së deklaramit për një periudhë kohe kam qenë në marrëdhënie qiraje dhe për pjesën tjetër kam qendruar në banesat të cilat janë marrë fizikisht në dorëzim nga prindërit e mi në cilësinë e mbajtësit të thjesht që buron nga marrëdhëniet familjare. Sipas praktikës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për këto marrëdhënie në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, subjektet e rivlerësimit kanë barrën e provës për të provuar se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me këta

³ Kushti është një ngjarje e pasigurt e së ardhmes.

⁴ Dorëzuar me pyetësorin standard.

persona, në kuptim të parashikimeve të legjislacionit të posaçëm që rregullon këtë fushë (Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurës Penale).

12.1. Ndodhur në këto kushte, deklaroj se me të gjithë personat që përmenden në këtë pyetësor, duke filluar që nga personi që i kam paguar qiranë (shtetësja J.B.) e prindërit e saj (shtetasit M.B. dhe A.B.) dhe me të gjithë personat me të cilët prindërit e mi kanë hyrë në një marrëdhënie juridiko-civile (Kontratat e shkëmbimit) që ka lidhje me apartamentin ku unë kam qëndruar dhe po qëndroj (shtetasen E.M. dhe H.M.) nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, pasi nuk i kam gjykuar kurrë gjatë ushtrimit të detyrës time si gjyqtar.⁵ Për të provuar këtë fakt do të paraqesë në cilësinë provës shkresore vërtetimin me Nr. *** Prot., datë 21.02.2020 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vërtetimin me Nr. *** Prot., datë 20.02.2020 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, gjykata ku unë kam ushtruar detyrën e gjyqtarit.[....]

1.6.2. Lidhur me saktësimin e adresës së apartamentit objekt i Kontratës së Shkëmbimit (Me kusht) me Nr. *** Rep., dhe Nr. *** Kol., datë 27.11.2015, subjekti i rivlerësimit në pyetësorin nr. 2 ka deklaruar se [....]

- Është i vërtet konstatimi i Komisionit që në Kontratën e Shkëmbimit datë 27.11.2015 "Apartament 2+1 me sip.113.79 m², shkalla *** kati i *** apartamenti ***; ndodhet në rr. "****" Tiranë" sipas Lejes së sheshit të ndërtimit dhe lejes së ndërtimit të miratuar në vitin 2003. Megjithatë sot në zonën e *** ku ndodhet dhe apartamentin për të cilën kërkohen saktësime janë krijuar dhe miratuar rrugë të reja. Prandaj, në kohën kur është deklaruar ky apartament nga ana ime, rruga e saktë nuk është "****" Tiranë, por rruga "****". Kjo rrugë ku ndodhen apartamentet me adresë: Rruga "****" Pall.*** ap.***, *** Tiranë dhe Rruga "****" Pall.***, shkalla ***, kati ***; ap.***, *** Tiranë, është miratuar me vendimin Nr. **, datë 29.09.2008 "Për emërtimin e pjesëve të territorit publik të pa emërtuar në Bashkinë Tiranë", të Këshillit Bashkiak Tiranë të cilin do ta gjeni bashkëlidhur.[....]

1.7 Vlerësimi i trupit gjykues

- Nisur nga sa është përshkruar dhe analizuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin pasurinë në përdorim në deklaratën veting dhe ato periodike vjetore. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe nga hetimi u provua burimi i ligjshëm i krijimit të pasurive në përdorim të subjektit.

- nga hetimi dhe shqyrtimi i kësaj pasurie, rezultoi e provuar se apartamenti i deklaruar në përdorim nga subjekti i rivlerësimit (posedim faktik pa qira për shkak të marrëdhënies të posaçme familjare) është përfituar me anë të shkëmbimit të pasurive të babait të subjektit. Burim i burimit të krijimit të çdo pasurie që është në pronësi të prindërve të subjektit të rivlerësimit apo që mund të fitojnë në të ardhmen nëse vërtetohet kushti pezullues, ku bën pjesë dhe apartamenti me adresë: Rruga "****" Pall.***, shkalla ***, kati ***; ap.***, *** Tiranë, është shkëmbimi i truallit prej 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë) m², që ndodhet në qytetin e Sarandës, lagjia nr. **, pasuria me nr. **, zona kadastrale **, i cili është blerë nga i ati i subjektit të rivlerësimit anë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., dhe nr. *** kol., datë 30.07.1996.

⁵ Për shkak të marrëdhënies së ngushtë familjare dyshimi për konflikt të mundshëm interesi me babain tim nuk ekziston.

Komisioni vlerëson gjithashtu se problrmatikat e evidentuara gjatë hetimit mbi shkëmbimet e pasurive të paluatshme nga ana e babait të subjekti, janë veprime të kryera nga babai i subjektit dhe që nuk ka elementë të cilët ndikojnë në vlerësimin e Komisionit përkundrejt subjektit, duke qenë se hetimit i Komisionit përqëndrohet në analizën e deklaramit dhe të burimit të krijimit të kësaj pasurie apo kontrollin nëse subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesave.

Komisioni vlerëson se koha e krijimit të kësaj pasurie nga personi tjetër i lidhur/babai i subjektit, pjesë e kontratës së shkëmbimit, daton në vitin 1996, kohë kur subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar funksionin e gjyqtarit, dhe pavarësisht hetimit të thelluar të komisionit, kjo pasuri nuk ndikon në procesin e rivlerësimit të subjektit.

Në përfundim të analizimit të deklaramit dhe burimit të krijimit të kësaj pasurie, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaramit të saktë dhe në përputhje me ligjin, dhe nuk janë evidenduar elementë apo indicie që të ndikojnë në procesin e rivlerësimit të subjektit.

2. Automjet Fiat Punto.

2.1. Subjekti në deklaramit vetting ka deklaruar: blerje automjeti, tip autoveturë, e markës “FIAT PUNTO”, viti i prodhimit 2001, ngjyrë blu, me targë ***, me kontratën e shitjes me datë 09.05.2014. Vlera e automjetit është 70.000 Lekë dhe zotërimi 50%. **Burimi i krijimit;** të ardhurat nga paga e deklaruesit dhe e bashkëshortes A.B. (M.) gjatë vitit 2014.

2.2. Me kontratën e shit-blerjes nr. ***, dt. 9.5.2014, rezultoi se subjekti ka blerë nga pala shitëse Elona Alsen automjetin tip Fiat Punto, me numër shasie ***, me targa ***, në vlerën 70.000 lekë. Për këtë automjet është lëshuar dhe çertifikata e pronësisë së mjetit rrugor më datë 5.6.2014, si dhe leja e qarkullimit.

2.3. Drejtoria e përgjithshme e shërbimeve të transportit rrugor me shkresat nr. *** prot., datë 25.7.2017, datë. 22.8.2017 dhe nr. *** prot., datë 30.6.2020, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka në pronësi asnjë automjet të regjistruar në emër të tij.

2.4 Analiza financiare.

Analiza e mundësisë së blerjes së automjetit FIAT - * dt. 09/05/2014**

Te ardhura nga paga subjekti E. Bani 01/01/14 - 09/05/14	413,525
Te ardhura nga paga bashkeshortja A. B. 01/01/14 - 09/05/14	4,098
Te ardhura totale	417,623
Shpenzime jetese 01/01/14 - 09/05/2014	146,665
Blere automjet FIAT - *** dt. 09/05/14	70,000
Shpenzime shtese per automjetin	57,000
Shpenzime totale	273,665
Ndryshim likuiditeti 01/01/14 - 09/05/2014	78,165
Mundesia e blerjes se automjetit FIAT - ***	65,792

2.4.1 Bazuar në këtë analizë financiare rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja e tij, kanë patur burime të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, shtimin e likuiditeteve dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të kësaj periudhe.

2.5 Këtë automjet subjekti i rivlerësimi e ka shitur më pas me anë të kontratës së shitjes me nr. *** Rep., nr. *** Kol., më datë 26.03.2016, në vlerën 1.100 Euro. Palë blerëse rezultoi A.A. dhe sipas kontratës subjekti është likuajduar jashtë zyrës noteriale për vlerën e shitjes së automjetit.

2.6 Në deklaratën periodike për vitin 2014 subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit në vlerën prej 70,000 lekë, por nuk ka deklaruar burimin e blerjes së kësaj pasurie.

2.7 Në deklaratën periodike për vitin 2016 subjekti ka deklaruar shitjen e këtij automjeti në vlerën prej 1,100 euro.

2.8 Rezultoi se vlera e blerjes së këtij automjeti është më e vogël se vlera e shitjes së tij pas 2 vjet përdorimi.

2.9 Për këtë gjetje është pyetur subjekti i rivlerësimi:

-Në deklaratën periodike për vitin 2014 keni deklaruar blerjen e pasurisë automjet në vlerën 70,000 lekë, pasuri të cilën e keni deklaruar të shitur në vitin 2016 në vlerën 1,100 euro.

-Mund të deklaroni dhe shpjegoni si është blerë më lirë dhe është shitur pas 2 vjetëve më shtrenjtë kjo pasuri dhe nëse janë paguar detyrimet në momentin e shitjes në buxhetin e shtetit (tatim mbi të ardhurat)?

-Gjatë veprimtarisë tuaj si gjyqtar keni pasur ndonjë çështje gjyqësore me palën shitëse të automjetit A.A. dhe palën blerëse E.A., si dhe nëse jo mund të paraqisni dokumentacion provues?

2.10 Në përgjigje të pyetsorit nr.2 subjekti ka deklaruar:

*-Deklaroj se shtetësja E.A. ka qenë shoqja e ngushtë e bashkëshortes time. Automjetin shtetësja E.A. kishte disa muaj që nuk e përdorte dhe në kohën që unë jam emëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, më duhej një makinë e vogël dhe ekonomike. Nga shtetësja E.A. mu propozua që mund të përdorja automjetin e saj, ndërkohë që unë i propozova për ta blerë. Automjeti ishte i amortizuar dhe, për rrjedhojë bëm një vlerësim të tij në atë kohë në vlerën 100.000 lekë. Ende pa lidhur kontratën, në rrugën e parë që bëra për në qytetin e Shkodrës, u dogjë motori i mjetit. Ndodhur në këto kushte, unë kam shpenzuar shumën 30.000 lekë për blerjen e një motori tjetër të përdorur, 10.000 lekë për shërbimin e vendosjes së motorit dhe 5.000 lekë për karrotrecin.⁶ Për këto arsye, unë i kam paguar shtetases E.A. me lidhjen e Kontratës së Shitblerjes Nr. *** Rep., dhe Nr. *** Kol., datë 09.05.2014 vlerën 700.000 lekë, duke u ulur vlera e paguar për motorin. Gjithashtu, në vijim unë kam bërë investime në automjet, duke ndëruar pjesë të cilat ishin të dëmtuara që në momenin e blerjes si psh, ndërrimi i grupit të timonit (elektrik) në vlerën 12.000 lekë e riparime të tjera. Ndërkohë që vetëm 1 muaj përpara se t'ia shisja këtë automjet me kontratën e shitjes me Nr. *** Rep., dhe Nr. *** Kol., datë 26.03.2016 shetasit A.A. unë i kam blerë katër goma të reja automjetit si dhe i kam ndëruar katër amortizatorët, duke shpenzuar një vlerë rreth 40.000 mijë lekë.*

-Pra, vlera e investuar nga ana ime për këtë automjet kap vlerën mbi 97.000 lekë mbi vlerën e blerjes 70.000 lekë. Në pikën 3.6 gërma "b" të udhëzimit Nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, nën titullin "SHPENZIME TË PANJOHURA" parashikohet shprehimisht se: "Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, nuk do të njihen si shpenzime të zbritshme, shpenzimet e mëposhtme:b. Kosto e blerjes, përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve, të cilat janë objekt i amortizimit.

⁶ Për faktin që është djegur motori dhe kam shpenzuar vlerën e mësipërme ka qenë dëshmitar dhe kolegu im gjyqtari S.Sh., i cili konfirmon faktet e mësipërme nëpërmjet Deklaratës Noteriale me Nr. *** Rep., dhe Nr. *** Kol., datë 20.01.2021.

Për efekte fiskale, në kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të qëndrueshme hyjnë shpenzimet që kanë për qëllim përmirësimin e kapacitetit përfitues të ardhshëm të aktiveve dhe vlera e të cilave është më e madhe se 15 përqind e vlerës kontabile të mbetur të aktiveve për të katër kategoritë e tyre”. Pra, nëse vlera e investimit është mbi 15 përqind e vlerës kontabile të mbetur të aktiveve, për efekte fiskale hyjnë në shpenzimet që kanë për qëllim përmirësimin e kapacitetit përfitues të ardhshëm të aktiveve. Në rastin konkret vlera e investuar është mbi 100%, për rrjedhojë njihet si shpenzim për efekte të përcaktimit të fitimit të tatuëshëm.

*- Deklaroj se me shtetasit E.A. dhe A.A. nuk ndodhem në situatën e konfliktit të interesit pasi nuk i kam gjykuar kurrë gjatë ushtrimit të detyrës time të gjyqtarit. Për të provuar këtë fakt do të paraqesë në cilësinë provës shkresore vërtetimin me Nr. *** Prot., datë 21.02.2020 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vërtetimin me Nr. *** Prot., datë 20.02.2020 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, gjykata ku unë kam ushtruar detyrën e gjyqtarit.*

2.11 Vlerësimi i trupit gjykues

Subjekti i rivlerësimit edhe pas kalimit të barrës së provës nuk paraqiti dokumentacion justifikues lidhur me shpenzimet e pretenduar të kryera për këtë automjet. Gjithsesi Komisioni vlerëson se shpenzimet e kryera sipas deklarimit nga subjekti janë shpenzime rutinë për mirëmbajtjen e mjetit. Më tej, Komisioni evidenton se subjekti i rivlerësimit ka paguar detyrimet përkatëse mbi vlerën e shitjes së mjetit në raport me vlerën e blerjes (blerë 70,000 lekë shitur 1,100 euro), vetëm pas kalimit të barrës së provës. Për rrjedhojë këto të ardhura nuk janë konsideruar në analizë financiare. Gjithsesi nga analiza vjetore e kryer nga njësia ligjore, Subjekti i rivlerësimit ka burime të ligjshme për të blerë pasuritë dhe kryer shpenzimet .

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklarimin e shpenzimeve dhe ka burime të ligjshme për blerjen e automjetit dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin përkatës.

3. Automjet tip Toyota

3.1. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën vetting ka deklaruar blerje automjeti tip veturë, e markës “TOYOTA YARIS”, viti i prodhimit 2006, me targë *** (vlera 4,500 euro).

3.2. Burimi i krijimit, janë deklaruar të ardhurat nga shitja e autoveturës të markës “FIAT PUNTO”, viti i prodhimit 2001, në vlerën 1,100 euro dhe kursimet nga paga dhe të ardhurat e tjera të deklaruesit dhe bashkëshortes A.B. (Viti 2013 kursime 200,000 Lekë + viti 2014 kursime 100,000 Lekë + viti 2015 300,000 Lekë = 600,000 Lekë. Bashkëlidhur subjekti ka lidhur dhe kontratën si dhe çertifikatën e pronësisë.

3.3. Kjo pasuri rezultoi se është blerë me kontratën e shit-blerjes me nr. *** Rep., dhe nr. *** Kol., datë 30.05.2016, e cila rezultoi se është në bashkëpronësi me bashkëshorten A.B. dhe është regjistruar edhe në emrin e subjektit.

3.4. Bazuar në këtë kontratë shitje të datës 30.5.2016, pala shitëse E.Z. i ka shitur palës blerëse A.M. dhe E.B., automjetin tip Toyota Yaris, ngjyrë blu, me numër shasie ***, vit prodhimi 2006, në vlerën 4.500 euro.

3.5. Për këtë automjet është lëshuar çertifikata e pronësisë (datë 30.5.2016) së mjetit rrugor me targa *** në emër të Erjon Bani dhe A.B.

3.6. Drejtoria e përgjithshme e shërbimeve të transportit rrugor, me shkresat nr. *** prot., dt. 25.7.2017, dt. 22.8.2017 dhe nr. *** datë 30.6.2020, konfirmon se A.B. (M.) ka në pronësi mjetin me targa ***.

3.7. Nuk është konstatuar gjatë hetimit ndonjë konflikt i mundshëm interesi të subjektit me palën shitëse apo blerëse.

3.8. Në deklaratën periodike për vitin 2016 subjekti ka deklaruar blerjen e këtij automjeti në vlerën prej 4,500 euro. Burimi i blerjes së kësaj pasurie është deklaruar njësoj si dhe në deklaratën vetting.

3.9 Analiza financiare

Analiza e mundesise se blerjes e automjetit Toyota Yaris - * dt. 30/05/16**

Te ardhura nga paga subjekti E. Bani 01/01/16 - 30/05/16	472,067
Te ardhura nga paga bashkeshortja A. B. 01/01/16 - 30/05/16	295,168
Te ardhura nga shitja e automjetit Fiat - ***	70,000
Te ardhura totale	837,235
Shpenzime jetese 01/01/16 - 30/05/16	195,910
Shpenzime udhetimi 01/01/16 - 30/05/16	108,892
Blere automjet Toyota Yaris - *** dt. 30/05/16	608,715
Shpenzim per Sicred A. B.	27,800
Shpenzime totale	941,317
Ndryshim likuiditeti 01/01/16 - 30/05/16	-513,149
Mundesia e blerjes se automjetit Toyota Yaris – ***	409,066

3.9.1 Rezultoi se subjekti dhe bashkeshortja, kishin burimet e ligjshme për blerjen e kësaj pasurie dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të kësaj periudhe.

3.10 Është pyetur subjekti lidhur me:

- Mund të deklaroni pse është vendosur adresa: Njësia Administrative nr.*** “****” 234,113 si adresë në lejen e pronësisë së automjetit Toyota (leje e lëshuar në vitin 2016), si dhe të sqaroni lidhjen tuaj me pasurinë në fjalë.

3.11 Në përgjigje të pyetsorit nr.2 subjekti ka deklaruar:

*[...] Çertifikata e Pronësisë së Mjetit Rrugor me Nr. ***, datë 31.05.2016 është një dokument që është prodhuar dhe nënshkruhet vetem nga Drejtoria e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Adresa e pasqyruar në këtë dokument është gjeneruar nga sistemi i tyre që e merrë adresën automatikisht nga regjistri i gjendjes civile. Adresa: Njësia Administrative nr.*** “****” ***, *** është adresa ku unë dhe bashkeshortja ime kemi qenë të regjistruar në gjendjen civile.[...]*

3.12 Konkluzioni i Komisionit - nga hetimit dhe shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me këtë automjet, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka burime financiare të ligjshme për të blerë këtë automjet.

4. Depozitë bankare

4.1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratë depozitë Plus, me datë çelje 05.01.2016, e lidhur midis bashkëshortes së tij A.B. dhe CREDINS BANK Sh.a. Vlera është 100,104.28 lekë. Zotërimi 50%.

4.2. Bazuar në të dhënat e bankës Credins rezultoi një kontratë e depozitës plus nr.***, me Credins Bank, në emër të bashkëshortes së subjektit A.M.

4.3. Data e çeljes së depozitës, sipas kontratës në fjalë, është 05.01.2016 dhe me datë 08.01.2016 bëhet kalimi i parë nga llogaria e pagës në llogarinë e depozitës në vlerën 10.000 lekë. Në vazhdim, për çdo muaj bëhet një kalim i tillë duke rezultuar në një vlerë prej 100.104,28 lekë me datë 06.10.2016.

4.4. Bazuar në nxjerrjen e llogarisë bankare më datë 21.10.2016, nga Credins Bank në emër të A.M., shuma e depozitës është në vlerën 100.104 lekë.

4.5. Credins Bank, e ka konfirmuar këtë depozitë me shkresën nr. *** prot., datë 2.8.2017, ku më datë 21.10.2016, gjëndja e saj është në vlerën 100.104 lekë.

Konkluzioni i Komisionit - nga hetimit dhe shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me këtë depozitë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka burime financiare të ligjshme për të krijuar këtë depozitë.

5. Llogari rrjedhëse subjekti

5.1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje të llogarisë rrjedhëse në Credins Sh.a, më datë 21.10.2016. Bashkëlidhur subjekti ka paraqitur vërtetimin mbi llogarinë rrjedhëse të lëshuar nga Banka Credins sh.a, më datë 21.10.2016. Vlera është 110,045.82 lekë. Zotërimi 50%

5.2. Credins Bank, me shkresën nr. *** prot., dt. 2.8.2017 dhe nr. 20513/1 datë 23.10.2020, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka llogari page, me gjëndje në datën 21.10.2016, në vlerën 110.045 lekë.

5.3 Konkluzioni i Komisionit - nga hetimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me këtë llogari rrjedhëse, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka burime financiare të ligjshme për të krijuar transaksionet e ndodhura në këtë llogari rrjedhëse.

6. Llogari rrjedhëse bashkëshortja e subjektit

6.1 Subjekti ka deklaruar gjëndjen e llogarisë rrjedhëse në CREDINS BANK Sh.a, më datë 21.10.2016 në emër të bashkëshortes së tij. Bashkëlidhur vërtetimi mbi llogarinë rrjedhëse të lëshuar nga Banka Credins sh.a, më datë 21.10.2016. Vlera është 2,121.87 lekë. Zotërimi 50%.

6.2 Subjekti ka paraqitur dokument për nxjerrje llogarie bankare të datës 21.10.2016, nga Credins Bank, në emër të bashkëshortes A.M., në vlerën 2,121 lekë.

6.3 Credins Bank, me shkresën nr. *** prot., dt. 2.8.2017, dhe me shkresën nr.15514/1 datë 27.04.2021, konfirmon se A.M. ka llogari page në vlerën 2,121 lekë, në dt. 21.10.2016.

Konkluzioni i Komisionit - nga hetimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me këtë llogari rrjedhëse, Komisioni vlerëson se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka burime financiare të ligjshme për të krijuar transaksionet e ndodhura në këtë llogari rrjedhëse.

7. Gjendje cash

7.1 Subjekti ka deklaruar gjendje cash nga kursimet, si burim krijimi nga paga e tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe nga paga e bashkëshortes A.B. (M.), si Kryetare e Degës së Buxhetit Gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Vlera e deklaruar është 100,000 lekë. Zotërimi 100%.

7.2 Në deklaratën periodike për vitin 2016 subjekti ka deklaruar: *“Pakësim i kursimeve cash në vlerën 600,000 lekë, gjendja 50,000 lekë”*.

7.3 Është pyetur subjekti në lidhje me gjendjen cash dhe në përgjigje të pyetsorit nr.2 ka deklaruar:

*- Sikurse është deklaruar në Deklaratat Periodike Vjetore, në Deklaratën Vetting dhe në pyetësin standard, për periudhën e deklarimit unë kam kursyer cash këto vlera: i) Viti 2013 kursime 200.000 (dyqind mijë) Lekë; ii) viti 2014 janë shtuar kursime 100,000 (njëqind mijë) Lekë dhe iii) viti 2015 janë shtuar kursim 300,000 (treqind mijë) Lekë. Pra, për këto vite gjithsej kam kursyer 600.000 (gjashtëqind mijë) Lekë. Kjo shumë, pra 600,000 (gjashtëqind mijë) Lekë është pakësuar nga ana ime më datë 30.05.2016, pasi ka shërbyer si burim për blerje automjeti tip veturë, e markës “TOYOTA YARIS”, viti i prodhimit 2006, ngjyrë blu, me numër shasie ***, me targë ***, me Kontratën e Shitjes me Nr. *** Rep., dhe Nr. *** Kol., datë 30.05.2016. Ky fakt është deklaruar në Deklaratën Periodike Vjetore 2016 dhe në Deklaratën Vetting.*

*-Në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar kam dorëzuar Deklaratën e Pasurisë Vetting me datë 21.10.2016, provuar ky fakt me vërtetimin me Nr. *** Prot., datë 21.10.2016 të lëshuar nga ILDKPKKI. Sikurse sqarohet në paragrafin *** të këtij pyetësi objekt i deklarimit në Deklaratën Vetting janë ato pasuri apo të drejta që ekzistojnë ditën e dorëzimit të kësaj deklarate. Prandaj, nga ana ime është deklaruar gjendja cash që ekzistonte ditën e dorëzimit të deklaratës vetting në datën 21.10.2016, e cila ka qenë 100.000 (njëqind mijë) Lekë, pasi shuma tjetër cash është pakësuar më datë 30.05.2016 për blerjen e automjetit tip veturë, e markës “TOYOTA YARIS”, viti i prodhimit 2006. Ndërkohë që në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2016 që përfshinë periudhën e deklarimit nga data 01.01.2016-31.12.2016, kam deklaruar kursime cash 50,000 lekë, pasi kaq ka qenë gjendja në datën 31.12.2016. Pra, nga data 21.10.2016 deri më datë 31.12.2016 unë kam shpenzuar nga gjendja cash një vlerë prej 50,000 lekë. Nuk mund të deklarohej pakësim kjo shumë pasi Deklarata Vetting nuk është deklaratë periodike vjetore. Në faqen 4 të Deklaratës Periodike Vjetore të vitit 2016 kam cituar shprehimisht: “Deklaruesi Erjon Bani. Pakësimi i kursimeve gjendje cesh në shumën 600,000(gjashtëqind mijë) Lekë, si rrjedhojë e blerjes së automjetit tip veturë, e markës “TOYOTA YARIS”, viti i prodhimit 2006, ngjyrë blu, me numër shasie ***, me targë ***, me Kontratën e Shitjes me Nr. *** Rep., dhe Nr. *** Kol., datë 30.05.2016. Prandaj, gjendje cash në datën 31.12.2016 nga kursimet, si burim krijimi nga paga e deklaruesit Erjon Bani si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe nga paga e bashkëshortes A.M., si Kryetare e Degës së Buxhetit Gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është në shumën 50,000 (pesëdhjetë mijë) Lekë”.*

7.4 Konkluzioni i Komisionit – nga analizimi i deklaratave vjetore periodike në raport me deklaratën vetting, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka burime të ligjshme për krijimin e gjendjes cash sipas analizës financiare të viteve përkatëse.

Konstatime të tjera

8. Lidhur me depozitën bankare

8.1 ILDKPKI, ka deklaruar: *Depozita bankare dy emërore në BKT, me gjendje shumën 1.031.651 lekë, në emër të b/shortes së subjektit dhe shtetasit R.Ç., nuk është deklaruar në deklaratat e interesave private ndër vite dhe në Deklaratën e Pasurisë Vetting, si dhe mbetet e paqartë pjesa takuese respektive dhe burimi financiar i përdorur.*

Hetimi i Kryer nga Komisioni

8.2 Banka Kombëtare Tregtare me shkresën nr. *** prot., dt. 24.7.2017, dhe nr. *** datë 03.07.2020, ka konfirmuar se bashkëshortja e subjektit A.M., ka depozitë dy emërore në emër të R.Ç. dhe A.M., në vlerën 1.031.651 lekë, (gjëndje në dt. 26.10.2016).

8.3 BKT, me e-mailin e dt. 14.11.2018, dërguar ILDKPKI, ka referuar nxjerrje llogarie ku rezultoi se shtetasja A.M. dhe R.Ç., kanë llogari bashkë-emërore në monedhën lekë dhe euro.

8.4 Llogaria në lekë është hapur në dt. 24.7.2007, janë kryer kreditime në shuma të ndryshme të cilat kanë kaluar në depozitë. Depozita e fundit është e datës 3.9.2014, në shumën 999,445 lekë.

8.5 Llogaria në euro është hapur në dt. 21.10.2005, deri në datë 2.5.2011, janë kryer kreditime në shuma të ndryshme, të cilat kanë kaluar në depozitë. Në dt. 3.5.2011 shuma 19,000 euro, është transferuar nga llogaria, me përfitues Xh.C. dhe dhe L.C. Depozita aktualisht rezulton e mbyllur.

8.6 Rezultoi se depozita bankare dy emërore në BKT në lekë, në emër të b/shortes së subjektit dhe shtetasit R.Ç. nuk është deklaruar në deklaratat e interesave private ndër vite dhe në deklaratën e pasurisë vetting.

8.7 Duke qënë se ngelet e paqartë pjesa takuese respektive dhe burimi financiar i përdorur për depozitat në lekë dhe euro, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit lidhur me:

Mund të deklaroni pse nuk është deklaruar kjo llogari në deklaratën e pasurisë vetting dhe në deklaratat e interesave private ndër vite ? - Mund të deklaroni burimin e ligjshëm të krijimit dhe pjesa takuese respektive të 2 depozituesve? - Mund të deklaroni lidhjen me shtetasin R.Ç. dhe shkakun e krijimit të kësaj depozite nga bashkëshortja juaj me këtë shtetas?

8.8 Në përgjigje të pyetsorit nr.2 subjekti deklaroi⁷:

-Bashkëshortja ime A.B. rreth datës 14.07.2020 nga një punonjëse e bankës BKT sh.a që merret me përditësimin e të dhënave personale të personave që rezultojnë klient në sistemin e bankës, ka marrë dijeni se pranë Bankës Kombëtare Tregëtare sh.a është hapur një Depozitës Bankare më datë 03.09.2014, me gjendje 1,051,465.2 lekë. Sipas dokumentit bankar rezulton si titullarë i kësaj depozite "R.Ç. ose A.M.". Ndërkohë që bashkëshortja ime dhe unë nuk kishim asnjë dijeni lidhur me faktin se si është krijuar kjo depozitë, kush janë të ardhurat që kanë shërbyer për këtë depozitë dhe kush e ka nëshkruar këtë kontratë për krijimin e kësaj depozite, si dhe përse rezulton emri i bashkëshortes në këtë depozitë.

-Për këto arsye, i është kërkuar informacion me email nga ana e bashkëshortes A.B. shtetasit R.Ç., i cili është daja (vëllai i nënës) i bashkëshortes ime.

⁷ Shiko shpjegimet e subjektit në përgjigje të pyetsorit nr.2

Në përgjigje R.Ç. ka deklaruar:

*-Me datë 03.09.2014 midis meje dhe Bankës Kombëtare Tregëtare Sh.a, është lidhur Kontrata e Depozitës Bankare me Nr. Reference ***. Pra, depozita që tashmë është me gjendjen 1,051,465.2 lekë është krijuar prej meje dhe në kontratën që unë kam rezulton vetëm nënshkrimi im dhe jo nënshkrimi tënd. Si burim për krijimin e kësaj depozite kanë shërbyer vetëm të kursimet e mia familjare dhe ju nuk keni kontribuar, si dhe nuk keni asnjë lidhje me këtë depozitë. Kjo kontratë nuk është lidhur në dobi të ndonjë personi të tretë, për rrjedhojë as në dobin tuaj. Kjo është një depozitë e krijuar nga unë me kursimet e mia familjare dhe për llogarin time e të familjes time. Pasqyrimi në kontratë i emrit tënd si klient, duhet të jetë gabim material i Bankës Kombëtare Tregëtare Sh.a, që ka përpiluar kontratën që më është vënë në dispozicion për t'u firmosur nga ana ime. Prandaj, nga ana ime do t'i kërkohej bankës që të bëjë korrigjimet e nevojshme pasi unë të vijë në Shqipëri, pasi nuk mund të lëviz për momentin për shkak të COVID 19.*

8.9 Bazuar në kontratën e datës 3.9.2014 rezultoi se bashkëshortja e subjektit figuron si palë në kontratë por kjo kontratë nuk është nënshkruar prej saj.

8.10 Lidhur me dijeni ose jo të depozitës 2 emerore i referohemi shkresës së BKT datë 9.11.2020. Sipas kësaj shkrese theksohet se:

- depozita në fjalë ka 2 titullarë “R.Ç. ose A.B.”;

- në lidhje me pretendimin se A.B. (M.) nuk ka shprehur vullnetin për të krijuar marrëdhënje me BKT në kuadrin e depozitave që janë çelur, sqarohet se ky vullnet nga ana juaj është dhënë që në momentin që keni pranuar çeljen e llogarisë rrjedhëse “R.Ç. ose A.B.”

- pretendimi i z. R.Ç. se nuk ka patur dijeni që depozita ka qenë dyemërore automatikisht bie poshtë pasi jo vetëm që ky fakt pasqyrohet qartësisht në kontratën e depozitës së nënshkruar prej tij, por edhe është sqaruar nga stafi i bankës kur depozita është lidhur me llogarinë rrjedhëse dyemërore.

8.11 Nga historiku i veprimeve të kryera në llogarinë 2 emërore “R.Ç. ose A.B.”, rezultoi se nga ana e bashkëshortes së subjektit dhe R.Ç. janë hapur 2 depozita bankare. Njëra depozitë është në lekë dhe rezulton e hapur më datë 24.7.2007 me depozitim 75,000 lekë. Depozita tjetër rezulton në euro me datë 21.10.2005. Në këtë depozitë në euro veprimi i fundit është bërë më datë 2.5.2011, pra përpara martesë me subjektin e rivlerësimit⁸.

8.12 Rezultoi se më datë 3.9.2014 është lidhur kontratë depozitë bankare me afat dhe vlerë krijimi 999,445 lekë. Shuma për krijimin e kësaj llogarie do merret nga llogaria e mëparshme bankare në lekë (llogaria e sipërpërmendur). Kjo kontratë është nënshkruar vetëm nga shtetasi R.Ç. Subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë deklaruar apo pretenduar ndonjë të ardhur nga kjo depozitë dhe nuk janë përfshirë në analizën financiare vlerat e këtyre llogarive dhe depozitave.

8.13. Në prapësimet e depozituara me email më datë 17.05.2021 lidhur me këtë depozitë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se [...]

*4.1. Sikurse e kam sqaruar në pyetësin Nr. 2, dëshiroj të theksoj edhe njëherë se bashkëshortja ime A.B. nuk ka asnjë lidhje faktike dhe juridike me depozitën bankare pranë Nr. Reference: ***, datë 03.09.2014, të lidhur midis shtetasit R.Ç. dhe BKT sh.a. Kjo për këto arsye:*

⁸ Shiko përgjigjen e BKT nr.*** datë 3.7.2020

4.2. Nga ana e BKT sh.a me shkresën Nr. *** Prot., datë 09.11.2020 me lëndë: “Kthim përgjigje” drejtuar z. R.Ç. dhe bashkëshortes time A.B. është përcjellë dokumentacioni që ka shërbyer për krijimin e Depozitës Bankare me Nr. Reference: ***, datë 03.09.2014 të lidhur midis shtetasit R.Ç. dhe BKT sh.a. Nga dokumentacioni rezulton që të jenë kryer në mënyrë kronologjike këto veprime juridike:

- 1) Më datë 28.12.2012 midis shtetasit R.Ç. dhe BKT sh.a është lidhur Kontrata e Depozitës Bankare me Nr. Reference: ***, me afat 6 mujor, me datë maturimi 28.06.2013, në shumën 260,000 lekë. Më datë 03.09.2014 nga shtetasi R.Ç. është bërë kërkesë për mbylljen e kësaj Depozite Bankare. Kjo kërkesë është miratuar dhe nënshkruar nga shtetasi R.Ç. dhe BKT sh.a. Në datën e mbylljes së kësaj depozite shuma e maturuar ka qenë 273, 042.29 lekë.
- 2) Më datë 28.12.2012 midis shtetasit R.Ç. dhe BKT sh.a është lidhur Kontrata e Depozitës Bankare me Nr. Reference: ***, me afat 3 mujor, me datë maturimi 02.03.2013, në shumën 406, 318.76 lekë. Më datë 03.09.2014 nga shtetasi R.Ç. është bërë kërkesë për mbylljen e kësaj Depozite Bankare. Kjo kërkesë është miratuar dhe nënshkruar nga shtetasi R.Ç. dhe BKT sh.a. Në datën e mbylljes së kësaj depozite shuma e maturuar ka qenë 423, 772.54 lekë.
- 3) Më datë 16.08.2013 midis shtetasit R.Ç. dhe BKT sh.a është lidhur Kontrata e Depozitës Bankare me Nr. Reference: ***, me afat 3 mujor, me datë maturimi 19.11.2013, në shumën 150.000 lekë. Më datë 03.09.2014 nga shtetasi R.Ç. është bërë kërkesë për mbylljen e kësaj Depozite Bankare. Kjo kërkesë është miratuar dhe nënshkruar nga shtetasi R.Ç. dhe BKT sh.a. Në datën e mbylljes së kësaj depozite shuma e maturuar ka qenë 152, 631.76 lekë.
- 4) Më datë 02.09.2014 nga shtetasi R.Ç. është depozituar cash pranë BKT sh.a shuma prej 150.000 lekë. Kjo shumë së bashku me shumën 849, 445.59 lekë, të akumuluar nga tre depozitat e mësipërme u ri-investua nga shtetasi R.Ç. në një depozitë të re, konkretisht është krijuar Depozita Bankare me Nr. Reference: ***, datë 03.09.2014 të lidhur midis shtetasit R.Ç. dhe BKT sh.a, me afat 1 vjeçar, me datë maturimi 03.09.2015, në shumën 999, 445.59 lekë.

4.2.1. Nga statement-i i llogarisë me Nr. *** pranë BKT sh.a në Lekë të datës 19.10.2020 nuk rezulton që bashkëshortja ime A.B. të ketë kryer veprime në këtë llogari si tërheqje apo depozitim të të hollave që kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitave bankrate të krijuara midis shtetasit R.Ç. dhe BKT sh.a. Të gjitha veprimet sipas edhe deklaratës së shtetasit R.Ç. janë kryer prej këtij të fundit dhe bashkëshortes së tij shtetases F.Ç. Pra, nga bashkëshortja ime A.B. (M.) nuk është kryer asnjë veprim të vetëm në këtë llogari bankare që nga krijimi i saj.

4.2.2. Gjatë hetimi administrativ u provua se shtetasi R.Ç. nuk vepron si përfaqësues i bashkëshortes time pasi nuk është autorizuar për të kryer një veprim të tillë (nuk ka prokurë) dhe nga përmbajtja e veprimeve juridike nuk rezulton që të ketë nënshkruar me këtë cilësi.

4.3. Sa më sipër, çmoj të sqaroj më poshtë nëse mbi bazën e fakteve të mësipërme në kuptim të Kodit Civil, a mund të konsiderohet se bashkëshortja ime A.B. ka hyrë në një marrëdhënie juridike civile që rrjedhë nga Kontrata e Depozitës Bankare me BKT sh.a dhe a mundet që të bëhet ajo palë në një kontratë pa shprehur vullnet për të qënë pjesë e saj. [...]

4.3.3. Mbështetur në kuadrin ligjor të cituar më lartë dhe nga provat që do administrohen rezulton se bashkëshortja ime A.B. nuk mund të konsiderohet titullare e depozitës bankare

të krijuar me Kontratë Depozite Bankare me Nr. Reference ***, lidhur me datë 03.09.2014 midis shtetasit R.Ç. dhe Bankës Kombetare Tregëtare Sh.a. Kjo për arsyet si më poshtë vijon:

4.3.4. Së pari, në rastin konkret rezulton se, midis shtetasit R.Ç. dhe BKT sh.a është shfaqur vullneti për krijimin e këtyre veprimeve juridike: i) më datë 28.12.2012 është lidhur Kontrata e Depozitës Bankare me Nr. Reference: ***, me afat 6 muaj, me datë maturimi 28.06.2013, në shumën 260,000 lekë; ii) Më datë 28.12.2012 është lidhur Kontrata e Depozitës Bankare me Nr. Reference: ***, me afat 3 muaj, me datë maturimi 02.03.2013, në shumën 406, 318.76 lekë; iii) më datë 16.08.2013 është lidhur Kontrata e Depozitës Bankare me Nr. Reference: ***, me afat 3 muaj, me datë maturimi 19.11.2013, në shumën 150.000 lekë. Mbështetur në nenin 659 të Kodit Civil, nën titullin “Përmbajtja e kontratës” ku parashikohet shprehimisht se: “Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike.”, shtetasi R.Ç. dhe BKT sh.a shprehur vullnetin e tyre të ligjshëm për krijimin e një marrëdhënie juridike që është që rrjedhë nga Kontrata e Depozitës Bankare me afat. Nuk rezulton që bashkëshortja ime A.B. të jetë palë e këtyre kontratave dhe për rrjedhojë të ketë shfaqur vullnet për të hyrë në një marrëdhënie juridike civile që rrjedhë nga Kontrata e Depozitës Bankare me afat. Sipas nenit 690 të Kodit Civil kontrata ka fuqi detyruese vetëm midis palëve, për rrjedhojë kontrata e depozitës nuk mund të krijoj të drejta dhe detyrime ndaj bashkëshortes time A.B. Pra, nuk mund të bëhet titullare një depozite bankare pa pëlqimin e saj dhe për një depozitë që nuk ka investuar asnjë qindark e për të cilën nuk ka pasur asnjë dajeni deri më datën 14.07.2020.[....]

4.3.7. Së katërti, në nenin 64 të Kodit Civil nën titullin “Kuptimi i përfaqësimit” parashikohet shprehimisht se: “Me përfaqësimin një person (përfaqësuesi) kryen, brenda tagreve që i janë dhënë nga ligji, nga prokura ose nga gjykata, veprime juridike në emër e për llogari të një personi fizik ose juridik tjetër (i përfaqësuar). Përfaqësimi nuk lejohet kur veprimi juridik duhet, sipas ligjit, të kryhet nga vetë personi. Nuk mund të veprojë si përfaqësues personi që nuk ka zotësi të plotë për të vepruar.”. Sipas kësaj dispozite tagrat për të vepruar në emër dhe për llogari të një personi tjetër jepen vetëm nga ligji, prokura ose nga gjykata. Pra, nuk mund të jepen me kontratë. Ligji nuk mund të autorizoj z.R.Ç. të veprojnë në emrin tim pasi ai nuk është kujdestari im ligjor. Po ashtu, nuk ka ndonjë vendim gjykate. Gjithashtu, në nenin 70 të Kodit Civil nën titullin “Përfaqësimi me prokurë” parashikohet shprehimisht se: “Prokura është dokumenti në të cilin i përfaqësuar, me vullnetin e tij të lirë ka përcaktuar karakterin dhe vëllimin e tagreve që i ka dhënë përfaqësuesit.”, ndërsa në nenin 78 të këtij Kodi nën titullin “Përfaqësimi pa tagre” parashikohet shprehimisht se: “Kur një person fizik ose juridik vepron si përfaqësues pa e patur këtë cilësi, si edhe kur përfaqësuesi ka kapërcyer tagret që i janë dhënë, veprimi juridik i kryer në këto kushte nuk është i detyrueshëm për personin në emrin e të cilit janë kryer, përveç kur ky e ka miratuar atë më vonë. Kur miratimi nuk është dhënë, personi i tretë që ka qenë në mirëbesim ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga përfaqësuesi.”. Sipas këtyre dispozitave tagrat e përfaqësimit përcaktohen në prokurë, duke u specifikuar dhe veprimet juridike që mund të kryhen pranë kësaj banke. Nëse një personi nuk i është dhënë ndonjë tagër nëpërmjet prokurës atëherë çdo veprim juridik që është bërë në emër dhe për llogari të tij nuk është i detyrueshëm për personin në emrin e të cilit janë kryer. Në rastin konkret duke i'u referuar të gjitha Kontratave të Depozitave Bankare nuk rezulton që shtetasi R.Ç. të veprojë në cilësinë e përfaqësuesit të bashkëshortes time A.B., pasi nuk ka nënshkruar me këtë cilësi, si dhe nuk është lëshuar nga bashkëshortja ime ndonjë prokurë për shtetasin R.Ç. për të lidhur ndonjë veprim juridik në emër dhe për llogari të bashkëshorte time. Prandaj, çdo veprim juridik i kryer

nga shtetasi R.Ç. nuk mund të sjelli asnjë pasojë juridike për bashkëshorten time edhe nëse ai do të kishte nënshkruar si përfaqësues e saj.[....]

*4.4. Sa më sipër u sqarua, deklaroj se bashkëshortja ime A.B. nuk ka asnjë lidhje faktike dhe juridike me depozitën bankare pranë Nr. Reference: ***, datë 03.09.2014, të lidhur midis shtetasit R.Ç. dhe BKT sh.a. Kjo për këto arsye: i) nuk është titullare e saj pas nuk ka shprehur kurrë vullnet për të hyrë në një marrëdhënie të tillë me BKT sh.a; ii) nuk ka lëshuar kurrë ndonjë prokurë për shtetasin R.Ç. që të veproj në emër dhe për llogari të saj; iii) nuk ka kontribuar asnjë qindark për krijimin e kësaj depozite; iv) nuk ka shfaqur vullnetin për të përfituar si person i tretë nga kjo depozitë bankare; v) nuk ka pasur asnjë dijeni për ekzistencën e kësaj depozite të paktën deri më datën 14.07.2020; vi) vendosja e emrit të bashkëshortes time në depozitës bankare është një veprim i BKT sh.a që bie në kundërshtim flagrant me nenet 64, 70, 78, 79, 659, 663 dhe 690 të Kodit Civil dhe me vendimet unfikuese Nr. 932, datë 22.06.2000 dhe Nr. 1, datë 06.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kjo për faktin pasi “Një kontratë nuk mund të bëjë debitor apo kreditor pa pëlqimin e tij një person të tretë”.[....]*

8.14 Vlerësimi i trupit gjykues

Trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë shpjegimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti,⁹ se vlerëson se ato rezultojnë bindëse, pasi provohet që bashkëshortja e tij nuk ka nënshkruar ndonjë kontratë depozite bankare me BKT sh.a si dhe nga statement-i i llogarisë me Nr. *** pranë BKT sh.a në lekë të datës 19.10.2020 nuk rezulton që bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit të ketë kryer veprime në këtë llogari si tërheqje apo depozitim të të hollave që kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitave bankrate të krijuara midis shtetasit R.Ç. dhe BKT sh.a. Të gjitha veprimet sipas edhe deklaratës së shtetasit R.Ç. janë kryer prej këtij të fundit dhe bashkëshortes së tij shtetases F.Ç. Gjithashtu, nuk provohet që bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit të ketë lëshuar ndonjë prokurë për shtetasin R.Ç. që të veproj në emër dhe për llogari të saj, gjë e cila do të krijonte dyshime për komisionin se bashkëshortja e subjektit kishte autorizuar këtë shtetas për të kryer llogari në emër të saj.

Në lidhje me depozitën në euro, krijuar më datë 21.10.2005, nga analizimi i kësaj llogarie rezulton se veprimi i fundit është bërë më datë 2.5.2011, kohë kur bashkëshortja nuk ishte në cilësinë e personit të lidhur, pasi nuk kishte lidhur martesë me subjektin. Ky fakt, tregon se ky veprim i saj nuk ndikon në procesin e rivlerësimit të subjektit, për më tepër që kjo llogari rezulton dhe e mbyllur tashmë.

Sa më sipër, trupi gjykues vlerëson të theksojë se pavarësisht fakteve të sipërpërmenduar dhe të të provkrijon bindjen se subjekti i rivlerësimit nuk kanë pasur detyrimin për deklarimin e një depozitë bankare ku ai dhe personi i lidhur me të nuk kanë interesa pasurore dhe për një depozitë që nuk ekziston ditën që ka filluar detyrën.

Trupi gjykues i Komisionit, vlerëson se nuk rezulton asnjë e dhënë e dalë gjatë deklarimeve në deklaratat periodike dhe as nga shpjegimet gjatë hetimit administrativ, se subjekti i rivlerësimit apo bashkëshortja e tij kanë përdorur të ardhura nga këto depozita si burim krijimi për ndonjë pasuri të krijuar prej tyre apo për të përballuar shpenzime të caktuara.

Më tej, trupi gjykues vlerëson se nuk rezultoi e provuar gjatë këtij procesi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë kontribuar në krijimin dhe gjendjen e këtyre depozitave .

⁹ Shiko shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorin nr. 2.

Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit konkludon se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin në lidhje me këtë depozitë dyemërore, pasaktësi e cila, e marrë vecmas, nuk është e mjaftueshme për të dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

1. Analiza financiare

SUBJEKTI I RIVLERESIMIT: ERJON J. BANI						
	2012	2013	2014	2015	2016	TOTAL
PASURI	20,802	171,158	198,922	250,208	276,079	917,169
						0
Automjet Fiat Punto *** - 70,000 leke - 2014 - 2016 - Erjon Bani - 50%			70,000			70,000
Automjet Toyota Yaris *** - 4,500€ - 2016 - 50%					608,715	608,715
						0
Ndryshim ne likuiditet	20,802	171,158	128,922	250,208	-332,636	238,454
DETYRIME	-36,812	0	0	0	0	-36,812
Kredi Raiffeisen - 2011	-36,812					-36,812
						0
PASURI NETO (PASURI - DETYRIME)	57,614	171,158	198,922	250,208	276,079	953,981
TE ARDHURA dokumentuar	924,870	1,201,997	1,411,730	1,713,060	1,987,923	7,239,580
Te ardhura nga pagat subjekti Erjon Bani	629,190	843,290	1,105,088	1,103,825	1,129,530	4,810,923
Te ardhura nga pagat bashkeshortja e subjektit A. M. B.	295,680	358,707	306,642	609,235	709,596	2,279,860
Te ardhura nga shitja Fiat Punto - 2016					148,797	148,797
						0
SHPENZIME	273,227	437,135	802,035	898,557	956,400	3,367,354
Shpenzime jetese	215,137	305,552	659,994	672,828	705,276	2,558,787
Shpenzime qiraje Rr. ***. - 2012-2013	48,000	76,200				124,200
Shpenzime interesi kredi Raiffeisen - 2011 - 2012	3,105					3,105
Shpenzim blerje telefon - 2011						0
Shpenzim per Sicred A. B.				24,400	48,800	73,200
Shpenzime mirembajtje automjet Fiat Punto			57,000		40,000	97,000
Shpenzime udhetimi	6,986	55,383	85,041	201,329	162,324	511,063
Analiza dokumentuar	594,028	593,704	410,773	564,295	755,444	2,918,245

Rezultoi se subjekti dhe bashkeshortja kanë pasur burime të ligjshme për shtim pasurish dhe mbulimin e shpenzimeve gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit.

9.1 Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare.

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga Raiffeisen Bank, Credins Bank, ABI Bank, Intesa SanPaolo Bank, Tirana Bank dhe Pro Credit Bank si dhe gjendjet cash të deklaruara nga subjekti.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

(i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në: Shkollën e Magjistraturës, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër (2014 – 2016), Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (2016), Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit Tiranë si dhe të ardhurat nga botime tek revista ***.

(ii) Të ardhura nga pagat e bashkëshortes së subjektit si financiere pranë kompanisë *** sh.a. (2012 – 2014) dhe si Kryetare e Degës së Buxhetit Gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (2015 – 2016).

Për vitet 2012 – 2014, të ardhurat e bashkëshortes nga kompania private *** sh.a., janë marrë nga statement bankar të Tirana Bank. Vlerat e këtyre të ardhurave nuk përputhen me vlerat e deklaruara në vërtetimet e kompanisë *** sh.a.

Gjithashtu vlera e lejes së lindjes së pretenduar nga subjekti nuk është e vërtetuar me transfertë bankare. Prandaj për vitin 2013 – 2014, janë marrë parasysht vetëm të ardhurat e vërtetuara nga statement bankar.

Pas përfundimit të hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit në lidhje me konstatimin e Komisionit se, leja e lindjes së bashkëshortes A.B. (M.) nuk ka kaluar nëpërmjet transfertës bankare, sqaroi se, praktika e kompanisë *** sh.a, ka qenë që, shuma që i korrespondonte lejes së lindjes merrej në arkën e shoqërisë nga punëmarrësi dhe kjo shumë i kalohej nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore kompanisë në cilësinë e punëdhënësit.

Në këto kushte, vlerat e këtyre të ardhurave nga leja e lindjes së bashkëshortes së subjektit u bënë pjesë e analizës financiare për vitin 2013 dhe 2014, referuar vërtetimit të DRSSH Tiranë, nr. ***, dt. 12.5.2021, të sjellë nga subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit.

(iii) Të ardhura nga shitja e automjetit Fiat Punto në vitin 2016

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

(i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së familjes, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT); Bashkangjitur shkresa e ILDKPKI nr. *** Prot. Dt. 04/03/2019.

(ii) Shpenzimet e qirasë (2012-2013) të deklaruar nga vetë subjekti.

(iii) Shpenzimet interesi kredi tek Raiffeisen (2011 – 2012) dhe shpenzime blerje telefon (2011)

(iv) Shpenzime për Sicred sipas statement Credins Bank nga bashkëshortja A.M.

(v) Shpenzime mirëmbajtje automjet Fiat Punto, deklaruar nga vetë subjekti

(vi) Shpenzimet e udhëtimit

Metodologjia për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit është bërë duke iu referuar vendimit nr. 11 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 22.05.2019 për subjektin E.I.

Në rastet kur qëndrimi është deklaruar dhe vërtetuar me dokumentacion shkresor, tek familjaret e subjektit/ bashkëshortit, nuk llogariten shpenzime qëndrimi. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti/ bashkëshorti kanë deklaruar e dokumentuar udhëtime për qëllime pune.

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive¹⁰.

Konkluzioni në lidhje me kriterin e pasurisë

1.1 Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të tij.

1.2 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Bani, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

Institucioni kompetent për kontrollin e figurës, verifikimit të deklarimeve të subjektit dhe të dhënave të tjera, me qëllim përcaktimin nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar, DSIK në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit Nr.8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 4 dhe nenin 37 dhe 38 të ligjit 84/2016, ka paraqitur pranë KPK raportin përfundimtar me nr. *** prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH, numër *** datë 5.5.2021, ku rezulton se :

- Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në përputhje me ligjin 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njejtat gjeneralitete si ato të deklaruara në Deklaratën për kontrollin e figurës.
- Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose persona të dyshuar të krimit të organizuar.
- Konstatohet se subjekti i rivlerësimit Erjon Bani, është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.
- Për pastërtinë e figurës, nuk ka pasur të dhëna e dyshime bazuar në të dhënat e administruara nga Komisioni si dhe raportin e DSIK.

Më tej, Komisioni konstatoi se nuk ka asnjë informacion apo *indicie* që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës, nuk ka të dhëna të tjera që të rezultojë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas primeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

¹⁰ Shih kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

Nga hetimit administrativ i Komisionit nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë ai është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Bani, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

C. VLERËSIMI AFTËSIVE PROFESIONALE

Raport i vlerësimit të aftësive profesionale është përgatitur bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) Aftësitë profesionale;
- b) Aftësitë organizative;
- c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale dhe
- ç) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit dhe 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit,;
- 2) 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet si më poshtë:

- Formulari paraqitet i plotë dhe i nënshkruar, pa mangesi e kundërtënie, sipas shtojcës që parashikon ligji.

- Subjekti nga tetori i vitit 2012 deri në janar të vitit 2014 ai ka kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në muajin janar të vitit 2014, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Në muajin nëntor të vitit 2016 ai është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vazhdon dhe aktualisht.

- Subjekti i rivlerësimit Erjon Bani ka deklaruar referimin se gjatë tre viteve të fundit i janë caktuar gjithsej 1184 çështje, ka përfunduar gjithsej 921 çështje, si dhe ka mbartur në tetor të vitit 2016 gjithsej 53 çështje.

- Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në Formular se ka ndjekur 18 seminare, duke iu referuar dokumentit të bashkëngjitur që vërteton kryerjen e tyre të Shkollës së Magjistraturës dhe që i përkasin periudhës së rivlerësimit në tre vitet e fundit.

- Gjithashtu referuar dokumentit që vërteton kryerjen e trajnimeve nga Shkolla e Magjistraturës, rezulton se subjekti i rivlerësimit Erjon Bani ka qenë lehtësues në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

- Sa u përket trajnimeve të tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit Erjon Bani ka deklaruar 4 të tilla në Formular, por vetëm njëri prej tyre i përkiste periudhës së rivlerësimit në tre vitet e fundit.

- Gjatë periudhës së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit Erjon Bani ka përzgjedhur dhe ka paraqitur 3 dokumente ligjore, të llojit vendim gjyqësor. Një vendim penal i përket vitit 2014, një vendim penal i përket vitit 2015 dhe vendimi i tretë penal, i përket vitit 2016.

1. **Dokumenti 1.** Vendimi penal nr. ***, datë 25.07.2014 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me Kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, kundër të pandehurve A.Sh., i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 79/dh, 25 e 278/5 të Kodit Penal; L.O., i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/2 e 278/4 të Kodit Penal dhe A.Sh., P.Sh. e B.L., të akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal.
2. **Dokumenti 2.** Vendimi penal nr. *** (***), datë 04.11.2015 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me Kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, kundër të pandehurit S.M., i akuzuar për veprën penale të “Mashtrim me sigurime”, të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal
3. **Dokumenti 3.** Vendimi penal nr. ***, datë 09.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, me Kërkues Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, kundër të pandehurve M.P., i akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 76 e 278/2 e 278/2 të Kodit Penal; A.T., E.N. e S.P., të akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal

PËRSHKRIMI I 5 DOSJEVE GJYQËSORE PËR GJYQTARIN ERJON BANI TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

Dosja 1. Çështja penale me nr. 1013 regj, datë 02.10.2015, që i përket të pandehurit E.M., i akuzuar për veprat penale të “Drejtimit të automjetit në mënyrë të parregullt” dhe “Mosbindja ndaj urdhërit të punonjësit të policisë”, të parashikuara përkatësisht nga nenet 291 e 242 të Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 28.10.2015.

Çështja me shortin e datës 06.10.2015, i është caktuar gjyqtarit Erjon Bani. Me vendimin e datës 09.10.2015, gjyqtari Erjon Bani ka vendosur kalimin e çështjes në seancën gjyqësore të datës 27.10.2015, ora 11.00, duke urdhëruar njëkohësisht sekretarinë gjyqësore të njoftojë palët ndërgjyqëse.

Seanca 1 gjyqësore e datës 27.10.2015 është çelur në orën 11.11, me 11 minuta vonesë të parelatur dhe është dokumentuar me procesverbal, me regjistrim audio.

Seanca 2 gjyqësore e datës 28.10.2015 është çelur në orën 13.38, me 8 minuta vonesë, relatuar si shkak pritja e prokurorit dhe është dokumentuar me procesverbal, me regjistrim audio.

Gjykata ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor të çështjes, është tërhequr për vendim dhe në kthim ka shpallur:

“Deklarimin fajtor të të pandehurit E.M. për kryerjen e veprës penale të “Drejtimin të automjetit në mënyrë të parregullt”, dhe deklarimin fajtor të të pandehurit E.M. për kryerjen e veprës penale të “Mosbindja ndaj urdhërit të punonjësit të policisë”. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal dënimin përfundimtar të të pandehurit E.M. me 9 muaj burgim. Në zbatim të nenit 406/1 të K Pr Penale, të pandehurit E.M. i ulet 1/3 e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 6 muaj burgim”.

Rezulton nga aktet në dosje se kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim i pandehuri, por të cilin e ka tërhequr në datën 07.11.2016. Në këto kushte, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 14.11.2016 ka vendosur: *“Mospranimin e ankimit kundër vendimit nr. ***, datë 28.10.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, bërë nga i pandehuri”.*

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar nga gjyqtari Erjon Bani në datën 02.11.2015 - pas 5 ditëve nga shpallja, brenda afatit 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i K.Pr.Penale dhe gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Erjon Bani ka zgjatur gjithsej 26 ditë, në intervalin kohor 02.10.2015 - 28.10.2015. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard 9 mujor të caktuar nga pika 5 shkronja “a” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Gjyqtari ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për shqyrtimin e saj, duke proceduar me gjykim të shkurtuar.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti janë të sakta nga ana formale. Në dosje gjendet vendimi për kalimin e çështjes penale në gjykim, aktet e njoftimit të palëve, konkluzionet përfundimtare të palëve dhe fashikulli hetimor. Të dy procesverbalet gjyqësore të administruara në dosje janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, konform kërkesave të neneve 345/1 e 346 të K.Pr.Penale.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal, sipas nenit 383 të K.Pr.Penale. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Dosja 2. Çështja penale me nr. *** regj, datë 22.03.2015, që i përket të pandehurit B.S., i akuzuar për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278/2/3 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 04.06.2015

Çështja me shortin e datës 23.03.2015, i është caktuar gjyqtarit Erjon Bani. Në përfundim gjykata ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor të çështjes, është tërhequr për vendim dhe në kthim ka shpallur:

“Deklarimin fajtor të të pandehurit B.S. për kryerjen e veprës penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake” të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 muaj burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit B.S. për kryerjen e veprës penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake” të parashikuar nga neni 278/3 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 2 vjet e 4 muaj burgim. Bazuar në nenin 55 të Kodit Penal, dënimin përfundimtar të të pandehurit B.S. me 2 vjet e 6 muaj burgim. Në zbatim të nenit 406/1 të K Pr Penale, të pandehurit B.S. i ulet 1/3 e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 1 vit e 8 muaj burgim”.

Rezultoni nga aktet në dosje, se kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim i pandehuri, por e ka tërhequr atë në seancë gjyqësore. Në këto kushte, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. ***, datë 14.04.2016 ka vendosur: *“Mospranimin e ankimit kundër vendimit nr. ***, datë 04.06.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”*.

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar nga gjyqtari Erjon Bani në datën 08.06.2015 - pas 4 ditëve nga shpallja, brenda afatit 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i K.Pr.Penale.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Erjon Bani ka zgjatur gjithsej 2 muaj e 12 ditë, në intervalin kohor 22.03.2015 - 04.06.2015. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard 9 mujor të caktuar nga pika 5 shkronja “a” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Gjyqtari ka marrë masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për shqyrtimin e saj, duke proceduar me gjykim të shkurtuar.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti janë të sakta nga ana formale.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal, sipas nenit 383 të K.Pr.Penale. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

Dosja 3. Çështja penale me nr. *** regj, datë 14.05.2014, që i përket të pandehurit T.D., i akuzuar për veprën penale të “Ndërtim i paligjshëm”, të parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 18.06.2014.

Çështja me shortin e datës 18.05.2014, i është caktuar gjyqtarit Erjon Bani. Me vendimin e datës 26.05.2014, gjyqtari Erjon Bani ka vendosur kalimin e çështjes në seancën gjyqësore të datës 11.06.2014.

Pasi prokurori ka paraqitur dhe depozituar konkluzionet e tij përfundimtare me shkrim dhe i pandehuri fjalën e tij të fundit, gjykata ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor të çështjes, është tërhequr për vendim dhe në kthim ka shpallur:

“Deklarimin fajtor të të pandehurit T.D. për kryerjen e veprës penale të “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal dhe dënimit të tij me 1 vit burgim. Në zbatim të nenit 406/1 të K Pr Penale, të pandehurit T.D. i ulet 1/3 e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 8 muaj burgim. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim, duke e vënë në provë të pandehurin T.D, për një periudhë prove prej 18 muajsh, me kusht që gjatë kësaj kohe i pandehuri të mos kryejë veprë tjetër penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës një herë në muaj”.

Rezultoni nga aktet në dosje, se kundër këtij vendimi nuk është ushtruar ankim nga palët ndërgjyqëse. Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar nga gjyqtari Erjon Bani në datën 23.06.2014 - pas 5 ditëve nga shpallja, brenda afatit 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i K.Pr.Penale.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Erjon Bani ka zgjatur gjithsej 30 ditë, në intervalin kohor 18.05.2014 - 18.06.2014. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard 9 mujor të caktuar nga pika 5 shkronja “a” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Gjyqtari ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për shqyrtimin e saj, duke proceduar me gjykim të shkurtuar. Vendimi për caktimin e seancës së parë është marrë brenda 10 ditëve, e parashikuar nga neni

333/1 i K.Pr.Penale dhe data për seancën e parë është caktuar për më tepër se 10 ditë, në përputhje të nenit 333/2 të K.Pr.Penale. Edhe seanca e dytë është caktuar pas shtatë ditëve, duke respektuar afatin 15 ditor të parashikuar nga neni 342/2 i K.Pr.Penale. Janë caktuar 2 seanca gjyqësore, të cilat kanë qenë produktive. Në fillimin e dy seancave gjyqësore nuk ka pasur asnjë vonesë, por asnjera prej tyre nuk është dokumentuar me regjistrim audio. Sipas urdhrorit të brendshëm Nr. ***, datë 12.05.2015 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër sistemi Audio është instaluar në muajin maj 2015 dhe ka qenë e disponueshme vetëm pas datës 18.05.2015.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti janë të sakta nga ana formale.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal, sipas nenit 383 të K.Pr.Penale.

Dosja 4. Çështja penale me nr. *** regj, datë 08.03.2014, që i përket të pandehurit E.Sh., i akuzuar për veprën penale të “Vjedhjes” mbetur në tentativë, të parashikuar nga neni 134/1-22 i Kodit Penal, e përfunduar me vendimin nr. ***, datë 26.03.2014.

Çështja me shortin e datës **10.03.2014**, i është caktuar gjyqtarit Erjon Bani. Me vendimin e datës 11.03.2014, gjyqtari Erjon Bani ka vendosur kalimin e çështjes në seancën gjyqësore të datës 25.03.2014.

Janë zhvilluar 2 seanca gjyqësore gjithësej. Pasi prokurori ka paraqitur dhe depozituar konkluzionet e tij përfundimtare me shkrim dhe i pandehuri fjalën e tij të fundit, gjykata ka deklaruar të mbyllur shqyrtimin gjyqësor të çështjes, është tërhequr për vendim dhe në kthim ka shpallur:

“Deklarimin fajtor të të pandehurit E.Sh. për kryerjen e veprës penale të “Vjedhje”, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 134/1 e 22 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 3 muaj burgim. Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, të pandehurit E.Sh. i ulet 1/3 e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me 2 muaj burgim. Në zbatim të nenit 63 të Kodit Penal urdhërohet pezullimi i dënimit me burgim, duke e detyruar të pandehurin të kryejë 120 orë pune me interes publik për një periudhë prej 6 muajsh dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës”

Rezulton nga aktet në dosje, se kundër këtij vendimi nuk është ushtruar ankim nga palët ndërgjyqëse. Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar janë depozituar nga gjyqtari Erjon Bani në datën 31.03.2014 - pas 5 ditëve nga shpallja, brenda afatit 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i K.Pr.Penale.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Erjon Bani ka zgjatur gjithsej 16 ditë, në intervalin kohor 10.03.2014 - 26.03.2014. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit standard 9 muajor të caktuar nga pika 5 shkronja “a” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit. Kohëzgjatja e gjykimit respekton standardin për një proces të rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ.

Gjyqtari ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për shqyrtimin e saj, duke proceduar me gjykim të shkurtuar. Në fillimin e dy seancave gjyqësore nuk ka pasur asnjë vonesë, por asnjera prej tyre nuk është dokumentuar me regjistrim audio.

Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti janë të sakta nga ana formale.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal, sipas nenit 383 të K.Pr.Penale. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

1. Çështja administrativo-penale me nr. 1090 regj, datë 03.09.2016, që i përket Kërkuesit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, “Vleftësimin të ligjshëm të arrestit në flagrancë” dhe “Caktimin e masës së sigurimit personal Arrest në burg” ndaj personit nën hetim G.I., e përfunduar me vendimin nr. 1090, datë 04.09.2016.

Kjo çështje është regjistruar dhe i ka kaluar subjektit të rivlerësimit Erjon Bani në datën 03.09.2016. Me vendimin e datës 03.09.2016 Gjyqtari Erjon Bani ka caktuar seancën gjyqësore në datën 04.09.2016, ora 11.40.

Është zhvilluar vetëm një seancë gjyqësore ajo e datës 04.09.2016. Kjo seancë është çelur në orën 11:38 minuta dhe është dokumentuar me procesverbal, me regjistrim audio. Në përmbajtje të procesverbalit evidentohet se është paraqitur personi i arrestuar G.I., por nuk evidentohet nëse është paraqitur ose jo përfaqësuesi i Prokurorisë. Meqenëse i arrestuari kishte kërkuar avokat mbrojtës, gjykata ka vendosur të caktojë kryesisht një mbrojtës, të cilin e ka legjitimuar në seancë. Pasi ka deklaruar të hapur shqyrtimin gjyqësor të çështjes, gjykata ka shqyrtuar dhe administruar provat e paraqitura nga palët dhe kërkesat e tyre të fundit. Në përfundim, gjykata është tërhequr për vendim dhe në kthim, në orën 12:01 minuta ka shpallur:

“Të vleftësojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë të kryer nga policia gjyqësore me datë 01.09.2016, ora 09.30 ndaj të dyshuarit G.A.I. Caktimin e masës së sigurimit personal ndaj të dyshuarit G.A.I. masën e sigurimit personal “Arrest në burg” të parashikuar nga neni 238 i Kodit Pr.Penale”.

Rezulton nga aktet në dosje se kundër këtij Vendimi ka paraqitur ankim i dyshuari dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me Vendimin nr. ***, datë 26.09.2016 ka vendosur: *“Miratimin e Vendimit nr. ***, datë 04.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”.*

Dosja gjyqësore së bashku me vendimin e arsyetuar, janë depozituar nga subjekti i rivlerësimit Erjon Bani në kryesekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në datën 09.09.2016 – 5 ditë pas shpalljes, brenda afatit 5 ditor të përcaktuar nga neni 113 i K.Pr.Penale.

Gjykimi nga subjekti i rivlerësimit Erjon Bani ka zgjatur gjithsej 1 ditë, në intervalin kohor 03.09.2016, ora 12.30 minuta - 04.09.2016, ora 12.01 minuta. Kjo kohëzgjatje është brenda afatit procedural penal të 48 orëve, të përcaktuar në nenin 258 të Kodit të Pr.Penale. Kohëzgjatja e gjykimit respekton standardin për një proces të rregullt ligjor, referuar nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ.

Gjyqtari ka marrë të gjitha masat për menaxhimin e çështjes dhe kryerjen e veprimeve procedurale të nevojshme për shqyrtimin e saj, brenda afatit ligjor. Dokumentacioni në dosjen e vëzhguar është i rregullt dhe aktet e krijuara apo të vlerësuara nga subjekti janë të sakta nga ana formale. Dosja është e sistemuar në mënyrë kronologjike e në referencë të rregullave procedurale penale, duke u bërë i lehtë shfrytëzimi i saj nga palët.

Vendimi përfundimtar përmban strukturën e përcaktuar nga legjislacioni procedural penal, sipas nenit 245 të K.Pr.Penale. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

III. TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-SË

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtari Erjon Bani ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 08.07.2008 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2013. Pas studimeve, në datën 23.01.2014, ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe më pas, me vendimin nr.121 datë 18.11.2016 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është emëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku vazhdon dhe aktualisht.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Erjon Bani janë paraqitur 9 ankesa (1 në vitin 2013, 2 në vitin 2014, 5 në vitin 2015, 1 në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së.

6 ankesa (1 e vitit 2013, 1 e vitit 2014 dhe 4 të vitit 2015) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat 3 si ankesa të përsëritura më parë dhe 3 të tjera, me arsyetimin se nuk përmbajnë fakte dhe rrethana të vlefshme për verifikim.

3 ankesa janë verifikuar dhe kanë rezultuar:

- 1 ankesë e vitit 2014 verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, është mbajtur në verifikim në vijim deri në përfundim të gjykimit në Gjykatën e Lartë.
- 1 ankesë e vitit 2015 verifikuar për mosrespektim të solemnitetit, është arkivuar pasi nuk kanë rezultuar shkelje nga gjyqtari.
- 1 ankesë e vitit 2016 verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, është mbajtur në verifikim në vijim deri në përfundim të gjykimit.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Erjon Bani përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

I. ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLGJ.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Erjon Bani ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i zbaton ato në praktikë dhe në tekstin e vendimeve përfundimtare i përdor shpesh. Në të gjitha rastet u konstatua se, në funksion të zbatimit të ligjit ai përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë dhe asaj të Gjykatës Kushtetuese.

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se përgjithësisht ai identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në të gjitha çështjet penale të analizuara, është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke i kushtuar rëndësi të gjithë elementëve të veprës penale dhe arrin të analizojë shkaqet e posaçme dhe të dhënat që përlligjin ose jo arrestimin e personave

nën hetim dhe nëse masa e sigurimit e kërkuar nga organi i prokurorisë, i përshtatet kërkesave dhe kritereve ligjore të parashikuara nga ligji.

Gjithashtu rezulton se ka njohuri të mira të procedurave të gjykimit të çështjeve gjyqësore penale që ka shqyrtuar. Njeh aspektet e procesit të rregullt ligjor në drejtim të pjesëmarrjes së palëve në gjykim, të kontradiktoritetit e gjer tek arsyetimi i vendimit gjyqësor.

Natyra e çështjeve penale që ai ka shqyrtuar ka qenë e ndryshme dhe tregon gjerësinë e njohurive të tij të përfutuara përmes përvojës në punë.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit Erjon Bani ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej tij, janë të qarta dhe të kuptueshme. Në përgjithësi i respekton rregullat e drejtshkkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe gjithmonë janë përdorur të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten në gjuhësi normale, janë të kuptueshme dhe me referenca ligjore.

Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor. Vendimet përfundimtare të tij plotësojnë sipas rastit, kërkesat e legjislacionit procedural penal.

Arsyetimi i vendimit është gjithpërfshirës, në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

Gjithashtu, tek të 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se ai i kushton rëndësinë e duhur arsyetimit të vendimeve të ndërmjetme. Në çdo rast, vendimet e ndërmjetme jepen me tekst të qartë arsyetimi dhe gjithmonë kanë referuar edhe bazën ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, gjyqtari Erjon Bani ka përfunduar gjithsej 886 çështje gjyqësore, nga të cilat 879 çështje penale (576 penale themeli dhe 303 adm-penale e masa sigurimi) dhe 7 kërkesa civile.

Sipas pikës 3 shkronja “a”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë i dhomës penale, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në një vit, në jo më pak se 100 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundravajtje penale). Sipas këtyre të dhënave statistikore, konstatohet se ngarkesa sasiore e gjyqtarit Erjon Bani me 576 çështje penale themeli në tre vjet, ka qenë mbi standardin minimal.

Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Erjon Bani, në të gjitha rastet ka qenë brenda afateve standard apo ligjore dhe në intervale kohore nga 1 ditë deri në 2 muaj e 12 ditë. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari Erjon Bani i kushton shumë rëndësi arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve, pa patur vonesa dhe brenda afateve ligjore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit Erjon Bani ka aftësi për planifikimin dhe organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim, në funksion të zgjidhjes së çështjeve.

Janë vëzhguar gjithsej 14 seanca gjyqësore, nga të cilat 12 kanë qenë produktive. Pengesë në 2 seanca joproduktive kanë qenë caktimi i seancës gjyqësore në ditë feste zyrtare (1 seancë) dhe mosparaqitja e prokurorit (1 seancë).

Gjatë gjykimit, ai identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme për realizimin e tyre.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se ato kanë qenë të rregullta, të sakta dhe të plota. Për veprimet e kryera në seancë gjyqësore është mbajtur procesverbal gjyqësor, bazuar në dispozitat procedurale penale. Në çdo dosje të vëzhguar gjendet vendimi për caktimin e seancës gjyqësore, aktet e njoftimit të palëve, kërkesat me shkrim të tyre dhe provat e paraqitura. Të gjitha procesverbalet gjyqësore të administruara në dosje, rezulton se janë të plota, me të gjitha të dhënat dhe përsëkrimet për veprimet procedurale të kryera, me përjashtim të dosjes 5, në seancen e vetme të së cilës u konstatua se në verifikimin e paraqitjes së palëve, mungonte e pasqyruar prezenca e përfaqësuesit të Prokurorisë, kërkesë e nenit 348 të K.Pr.Penale. Megjithatë të gjitha procesverbalet rezultuan të nënshkruara nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtari, konform kërkesave të nenit 345 të K.Pr.Penale. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, veprimet që janë kryer në seancë dhe dispozitivin e vendimit në fund të shqyrtimit gjyqësor. Konstatohet se 11 nga 13 seancat gjyqësore të 5 dosjeve të vëzhguara, kanë rezultuar të padokumentuara me regjistrim audio. Sipas urdhrimit të brendshëm Nr. ***, datë 12.05.2015 të Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër sistemi Audio është instaluar në muajin maj 2015 dhe ka qenë e disponueshme vetëm pas datës 18.05.2015. Duket se në kohën kur janë zhvilluar seancat pa audio nuk ishte instaluar ky sistem pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Sa i përket fillimit me vonesë të seancës gjyqësore, rezultoi se nga 14 seanca të vëzhguara gjithsej, vetëm në 2 prej tyre është konstatuar vonesë në çeljen e seancës gjyqësore me 11 e 8 minuta dhe për njërin vonesë është pasqyruar e dokumentuar shkaku. Në rastin e vonesës më të vogël, 8 minuta, tek seanca gjyqësore e datës 28.10.2015, në dosjen 1, është dokumentuar si shkak *“pritja e prokurorit”*.

Dosjet janë të inventarizuara rregullisht dhe janë sistemuar në mënyrë kronologjike, në fillim janë vendosur aktet e paraqitura nga palët ndërgjyqëse e më pas aktet procedurale të krijuara nga gjykata, duke pasqyruar kronologji në renditjen e akteve dhe duke u bërë lehtësisht të shfytëzueshme për palët.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Erjon Bani përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Erjon Bani dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Erjon Bani, si dhe nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Erjon Bani nuk ka respektuar rregullat procedurale me pasojë cënimin e parimit të gjykatës së paanshme.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtari Erjon Bani komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elementë që lidhen me paanësinë e tij. Në të gjitha rastet e vëzhguara, nuk është konstatuar që palët të kenë paraqitur kërkesë për përjashtim të gjyqtarit, ndërsa nuk u konstatuan raste dhe as kërkesa të vetë gjyqtarit për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit Erjon Bani për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gadishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Erjon Bani, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë në 19 trajnime, gjithsej 32 ditë të formimit vazhdues, si dhe ka marrë pjesë edhe si ekspert lehtësues.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit Erjon Bani për vitin akademik 2013-2014 dhe 2014-2015, semestri i parë (muaji tetor-shkurt) ka ushtruar detyrën e petagogut të jashtëm pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Për të ushtruar veprimtarinë e mësimdhënies është pajisur me autorizim me vendimin Nr. *** datë 28.10.2013 dhe vendimin Nr. *** , datë 26.01.2015 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Po ashtu, subjekti i rivlerësimit Erjon Bani ka paraqitur edhe fotokopje të dy botimeve si bashkëpunëtor në Revistën “***” 2, e vitit 2012 me titull: “*Ndryshimi i cilësimit juridik të veprës penale dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor sipas KEDNJ*” dhe atë me titull: “*Procedura për caktimin e ekspertit dhe realizimin e ekspertimit të huaj*”, ndërsa në Revistën “***” 2014 ka paraqitur botimin me titull: “*Disa komente mbi ndryshimet e neneve 609 dhe 610 të K.Pr.Civile të bëra me Ligjin nr. 122/2013*”. Ndërkohë në faqen 9 të formularit të vetëvlerësimit profesional citohet dhe shkrimi me titull “*Pavlefshmëria e titullit ekzekutiv*”, botuar në Revistën “***”, të Shkollës së Magjistraturës, Tiranë 2012.

C. DENONCIME

Për subjektin e rivlerësimit janë paraqitur 23 denoncime. Disa nga denoncimet janë në mënyrë të përsëritur dhe gjithsej rezultuan 13 denoncues.

1. Denoncues V.Ç. (prot në KPK me nr. * datë 6.1.2020).** Nga ky denoncues rezultojnë 4 praktika:

- Nr. *** datë 14.10.2019
- Nr. *** datë 10.12.2019
- Nr. *** datë 10.12.2019
- Nr. *** datë 23.12.2019

Nuk rezultojnë indicie lidhur me shkelje të subjektit të rivlerësimit.

2. Denoncuese L.H. (prot. * datë 18.1.2018).** Denoncuesja denoncon disa subjekte ndër to dhe subjektin e rivlerësimit. Nga praktika e denoncueses nuk rezultoi ndonjë vendim i dhënë nga subjekti për t'u analizuar.

3. Denoncues * (prot. *** datë 8.2.2018).** Denoncimi është për subjektin M.B., por në këtë denoncim është përmendur dhe subjekti i rivlerësimit (për dhënie vendimi të padrejtë). Nuk është paraqitur nga denoncuesi vendim i subjektit për t'u analizuar, por duket se denoncimi ka të bëjë me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit.

4. Denoncues studio ligjore * (prot. *** datë 25.2.2019).** Nga kjo studio ngrihet çështja e konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes për shkak të funksionit të saj si Kryetare e degës së buxhetit në gjykatën e Tiranës. Për këtë çështje janë protokolluar dhe praktikat:

- Nr. *** datë 5.3.2019
- Nr. *** datë 13.3.2019
- Nr. *** datë 19.3.2019
- Nr. *** datë 15.4.2019

Për këtë çështje ILDKPKI më datë 22.2.2019 ka kthyer përgjigje ku thekson se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja për shkak të pozicionit nuk ndodhet ne situatën e konfliktit të interesit.

5. Denoncues shtetasi J.S. (nr. * datë 26.2.2018).** Denoncuesi denoncon subjektin e rivlerësimit për vendim të padrejtë. Denoncuesi ka paraqitur vendim e subjektit të datës 12.4.2017. Nuk konstatohen problematika nga ky vendim penal i subjektit të rivlerësimit.

6. Denoncues shtetasi J.B. (nr. * datë 15.6.2020).** Denoncuesi denoncon subjektin e rivlerësimit për vendim të padrejtë. Nuk është paraqitur ndonjë vendim gjyqësor për tu analizuar. Nga ky shtetas është paraqitur dhe kallëzimi penal (nr. *** datë 22.6.2020) të bërë ndaj subjektit të rivlerësimit. Ky denoncuar ka paraqitur përsëri të njëjtin denoncim më datë 18.05.2021, i cili pretendon për dhënie vendimi të padrejtë nga subjekti i rivlerësimit, duke e dënuar për një vepër penale për të cilën më herët është deklaruar i pafajshëm.

6.1. Lidhur me këtë denoncim i'u kërkuan shpjegime subjektit të rivlerësimit, i cili ka dhënë shpjegime të detajuara me shkrim dhe ka paraqitur prova shkresore. Në mënyrë të përmbledhur subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: i) ky është një denoncim i përsëritur nga ky shtetas pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Nga ana e Trupit Gjyqësor me të drejtë nuk është konstatuar ndonjë problematik, për rrjedhojë nuk më është kërkuar shpjegim për këtë denoncim; ii) pretendimi se denoncuesi është ndodhur përpara gjësë së gjykuar, është i pabazuar në prova, pasi është verifikuar se nuk ka pasur ndonjë vendim të formës së prerë ndaj tij; iii) pretendimet e denoncuesit J.B. mbi themelin e vendimit, në respektim të vendimit Nr. 11, datë 02.04.2008 të Gjykatës Kushtetuese, janë objekt vlerësimi vetëm nga një gjykatë më e lartë; iv) kjo çështje është jashtë periudhës së rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse lidhur me pretendimet e denoncuesit. Gjithashtu, Trupi gjykues çmon në rastin konkret ndodhemi përpara parashikimit të nenit 72 pika 4 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “4. Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.”.

7. Kërkesë për përjashtim të subjektit të rivlerësimi nga shqyrtimi i një çështje gjyqësore, drejtuar Kryetarit të Gjykatës Tiranë (nr. * datë 11.6.2019).** Nuk paraqiten elementet e një denoncimi.

8. Kallëzim penal nga studio ligjore * (nr. *** datë 20.7.2018).** Nuk paraqiten elementet e një denoncimi por të një kallëzimi penal. Rezulton se mbi këtë kallëzim penal është vendosur mosfillimi i procedimit penal dhe është lënë në fuqi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës. Nuk rezultojnë indicie lidhur me shkelje të subjektit të rivlerësimit.

9. Denoncues shtetasi A.M. (nr. * datë 19.9.2018).** Subjekti i rivlerësimit me vendimin e datës 1.2.2018 ka vendosur: Rrëzimin e kërkesës së denoncuesit dhe lënien në fuqi të vendimit të Prokurorisë për mosfillim të hetimit mbi kallëzimin penal të bërë. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin e datës 24.4.2018 ka vendosur: Ndryshimin e vendimit të subjektit të rivlerësimit, shfuqizimin e vendimit të organit të prokurorisë dhe kthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve.

Trupi gjykues çmon se vendimmarrja e subjektit, është cenuar prej vendimit të Gjykatës së Apelit, në drejtim të korrektësisë e zgjidhjes së saj dhe lidhet me bindjen e trupit gjykues mbi çmuarjen e provave, si dhe ballafaqimin e provave me ligjin materiale e procedural. Nuk evidentohen në pjesën arsyetuese të vendimit të apelit ndonjë shkelje të normave procedurale apo mosarsyetim të vendimit të dhënë prej subjektit të rivlerësimit. Përcaktimi nëse bindja e brendshme e trupit gjykues, në rastin konkret, ka qenë e duhura apo e drejta, del jashtë kompetencave të organeve të rivlerësimit, për sa kohë lidhet drejtpërdrejt me korrektësinë e vendimmarrjes bazuar në bindjen e brendshme, pra me atë aspekt të aftësive profesionale të magistratëve që nuk mund të gjykohej e të shërbejë si matës i aftësive të tyre profesionale në kuadër të këtij procesi.¹¹

10. Denoncim i shtetasit A.Sh. (nr. * datë 26.9.2018).** Dononcuesi denoncon trupën gjykuese ku pjesë e saj është dhe subjekti i rivlerësimit për gjykim të padrejtë. Është kërkuar pranë Gjykatës Lezhë vendimi nr. *** datë 9.9.2016 dhe informacion për ecurinë e procesit në shkallët e tjera të gjyqësorit. Për këtë çështje gjyqësore dosja është paraqitur nga Gjykata e Lartë me shkresën nr. *** prot datë 19.4.2021.

Nga shqyrtimi i praktikës së dosjes gjyqësore rezultoi se:

1. Prokuroria Lezhë pas hetimit të kryer ka kërkuar pranë Gjykatës së rrethit gjyqësor Lezhë; dënimin e shtetasit M.P. për vrasje me dashe dhe armëmbajtje pa leje; dënimin e shtetasve A.T. dhe E.N. për moskallëzim krimi; detyrim paraqitje për shtetasin S.P.
2. Kjo çështje është gjykuar më para nga Gjykata e rrethit gjyqësor Lezhë e cila me vendimin nr. *** datë 15.9.2014 ka vendosur; deklarinim fajtor të M.P. për vrasje dhe armëmbajtje pa leje; deklarinim fajtor të A.T. dhe S.P. për moskallëzim krimi. Ky vendim i shkallës së parë është prishur nga Gjykata e Apelit dhe është ridërguar për gjykim në shkallë të parë.

¹¹ Shih vendimin Nr. 16, datë 13.07.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pg 21.4.

3. Pas shqyrtimit të kësaj çështje, trupa gjyquese e Gjykatës Lezhë me kryesues subjektin e rivlerësimit me vendimin nr. *** datë 9.9.2016 ka vendosur; deklarin e pafajshëm të M.P. për vrasje me dashje dhe prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake; deklarin fajtor të M.P. për veprën penale prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake; deklarin fajtor të A.T. dhe S.P. për moskallëzim të krimit; pushimin e çështjes për E.N.
4. Vendimi i Gjykatës së rrethit Lezhë është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Shkodër e cila ka vendosur: Deklarin fajtor të M.P. për vrasje me dashje dhe prodhim dhe mbajtje të armëve luftarake dhe dënimin me 18 vite burg; deklarin fajtor të A.T. dhe S.P. për moskallëzim krimi; pushimin e çështjes për E.N.
5. Gjykata e apelit ka theksuar se vendimi i shkallës së parë është i pabazuar në prova dhe në ligjin material penal dhe atë procedural penal, si dhe është rrjedhojë e një interpretimi dhe çmuarje të gabuar të provave.
6. Çështja është në Gjykatën e lartë pas rekursit dhe pritet shqyrtimi i saj.

Pra rezultoi vendimi i gjykatës ku subjekti i rivlerësimit ka qënë kryesues është shfuqizuar nga Gjykata e Apelit. Duke mos trajtuar dhe diskutuar çështjen e vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit lindin disa dyshime të arsyeshme lidhur me referimin e veprës penale, provave të plota të administruara dhe përmendura dhe në vendim, në vlerësim dhe të vendimmarrjes më pas.

1. Me anë të këtij vendimi ku subjekti ka qënë kryesues nuk është deklaruar asnjë person fajtor për vrasje, ku humbi jetën shtetasi M.SH;
2. Janë dënuar 2 persona për moskallëzim krimi kur në vendim nuk përmendet fare krimi i kryer apo personat e dënuar për krim;
3. Nuk argumentohet vendimi i subjektit të rivlerësimit për deklarin e pafajshëm të shtetasit M.P, kur vetëm pjesën arsyetuese të vendimit janë rënditur faktet thëniet e dëshmitarëve dhe provat e mbledhura për të faktuar përgjegjësinë penale të këtij shtetasi.
4. Duket se gjykata e shkallës së parë nuk e ka zgjidhur çështjen duke i dhënë përgjigje akuzës së vrasjes së shtetasit M.SH, të ngritur nga prokuroria.

Lidhur me këtë denoncim bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84.2016 i'u kërkuan shpjegime subjektit të rivlerësimit, i cili lidhur me gjetjet e Komisionit ka deklaruar se: [...]

***10.2. Së pari,** vendimi për të cilin më kërkoni që të japë shpjegime është një prej tre dosjeve të përzgjedhura nga ana ime për periudhën e rivlerësimit i titulluar në raportin përfundimtar **“Dokument 3”**. Ky është vendimi më i drejtë, më profesional dhe më i arsyetuar, i dhënë nga ana ime gjatë gjithë karrierës si gjyqtar. Nuk kam asnjë dyshim mbi drejtësinë e këtij vendimi. Mbi bazën e provave të administruara duke e ballafaqur me ligjin material e procedural penal, si dhe duke mbajtur parasysh jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në asnjë rrethanë nuk mund të jepej një vendim i ndryshëm nga ana që është marrë nga ana ime në cilësinë e kryesuesit të trupit gjyqes. Duke mos pasur asnjë dyshim mbi drejtësisë e vendimit Nr. ***, datë 09.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë,¹² është përzgjedhur për të treguar aftësitë e mia profesionale në drejtim të njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, sikurse e kërkon neni 72 i Ligjit nr.*

¹² Për këtë çështje kam qënë i deleguar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. [...]

10.3. Së dyti, pasi u njoha me kopjen e akteve që kanë të bëjnë me këtë dosje gjyqësore, konstatoj se në vendimin e saj, nga Gjykata e Apelit Shkodër, **nuk evidentohen shkelje të normave urdhëruese procedurale apo mosarsyetim i vendimit gjyqësor**. Disponimi i Gjykatës së Apelit Shkodër, lidhet me mënyrën e vlerësimit të provave nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe vetëm për zgjidhjen e çështjes në themel. Duke i'u referuar pjesën arsyetuese të vendimi të Gjykatës së Apelit Shkodër rezulton se në respektim të nenit 427 pika 4 të K.Pr.Penale, ku parashikohet shprehimisht se: **“4. Kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, gjykata e apelit nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë rast gjykata e apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor.”**, Gjykata e Apelit Shkodër përsëriti shqyrtimin gjyqësor, duke rimarrë edhe njëherë të gjitha provat e debatuar gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë. Nga leximi i vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër konstatohen se rezultuan të njëjtat fakte, por edhe pse rezultuan të njëjtat fakte kjo e fundit, **mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë** vendosi të deklaroj fajtor të pandehurin M.P. që gjykata e shkallës së parë e deklaroj të pafajshëm.[....]

10.4. Së treti, ndryshe nga sa përmendet në raport, Gjykata e Apelit Shkodër **nuk ka shfuqizuar vendimin e shkallës së parë, por ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë për të gjitha disponimet mbi deklarimin fajtor të të pandehurve**, duke ndryshuar vendimin për deklarimin e pafajshëm të të pandehurit M.P., si dhe për masën e dënimit për disa prej të pandehurve, **mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë**. Pra, disponimi i Gjykatës së Apelit Shkodër është mbështetur në nenin 428 pika 1 gërma “a” dhe “b” të K.Pr.Penale lënie në fuqi të vendimit me një ndryshim. Qartësisht nga pjesa përshkruese - arsyetuese dhe dispozitivi i këtij vendimi **nuk konstatohet asnjë shkelje e dispozitave udhëruese procedurale me pasoja për procesin**. Në të kundërt Gjykata e Apelit do të dispononte prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim sipas nenit 428 pika 1 gërma “ç” të K.Pr.Penale. Prandaj, çmoj se në rastin konkret ndodhemi përpara parashikimit të nenit 72 pika 4 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: **“4. Vlerësuesi cmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.”**.

10.5. Së katërti, në mbështetje të standardeve ndërkombëtare që garantojnë pavarësinë e jashtme dhe të brendshme të gjyqtarit, shpreh vlerësimin tim që vendimet e cenuara për shkak të vlerësimit të ndryshëm të fakteve, rrethanave apo të provave nga gjykatat më të larta, nuk përbëjnë shkak për përgjegjësi disiplinore. Parimin e pavarësisë së brendshme të gjyqësorit e kam vlerësuar gjithmonë të lidhur ngushtë me pavarësinë e secilit gjyqtar individual gjatë ushtrimit të funksioneve të tij në gjykimin e çështjeve konkrete. Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të KE-së (2010)12 thekson se në marrjen e vendimit gjyqtari duhet të jetë i pavarur, i paanshëm dhe i aftë për të marrë vendime pa asnjë ndikim, presion, kërcënim apo ndërhyrje, të drejtpërdrejta apo të tërthortë, nga çdo autoritet, duke përfshirë edhe autoritetet e brendshme të gjyqësorit. **Organizimi i sistemit gjyqësor, në shkallë të ndryshme brenda gjyqësorit, nuk duhet të cenojë pavarësinë individuale të secilit gjyqtar.**¹³

¹³ Recommendation CM/Rec (2010)12, (pika 22-25 të tij)

10.6. Së pesti, e njëjta ankesë që është paraqitur përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për vendimin Nr. ***, datë 09.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është paraqitur edhe pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë në vitin 2016 pas dhënies së vendimit. Pasi është verifikuar ankesa nga inspektori më datë 05.12.2016 i është sugjeruar Kryeinspektorit të KLD-së arkivimi i saj pasi pretendimet e tij zgjidhen vetëm nëpërmjet ankimit në një gjykatë më të lartë. Pra, inspektoriati verifikon vetëm ato ankesa që nuk zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor. Ndodhur në këto kushte, në janar të vitit 2017 nga Inspektoriati i KLD-së është vendosur arkivimi i ankesës. Gjithashtu, fakti i arkivimit të ankesës i është komunikuar ankuesit me shkresën Nr. *** Prot., datë 23.01.2017 të Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. **Pra, kjo ankesë është verifikuar njëherë dhe është arkivuar pasi bëhet fjalë për çështje që zgjidhen vetëm nga një gjykatë më e lartë.**

Lidhur me vlerësimin e Komisionit duket se nuk është deklaruar asnjë person fajtor për vrasje, ku humbi jetën shtetasi M.SH. dhe duket se gjykata e shkallës së parë nuk e ka zgjidhur çështjen duke i dhënë përgjigje akuzës së vrasjes së shtetasit M.SH., të ngritur nga prokuroria, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se:

12. [...]..dëshiroj të theksoj se nga ana e trupit gjykues në paragrafët 44, 44.1, 44.2, 44.2.1, 44.2.2, 44.3, 44.3.1, 44.3.2, 44.3.3, 44.3.4, 44.3.5, 44.3.6, 44.3.7, 44.3.8, 44.3.9, 44.4, 44.4.1, 44.4.2, 45, 45.1, 45.2, 45.2.1, 45.2.2, 45.2.3, 45.2.4, 45.2.5, 45.2.6, 45.2.7, dhe 46, 46.1 të vendimit Nr. 262, datë 09.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë është konkluduar se fajtor për vrasjen e viktimës M.Sh. nuk është i pandehurit M.P. i akuzuar nga prokuroria, por i pandehuri E.N. për të cilën prokuroria kishte ngritur akuzën e “Moskallëzim krimi” parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal. Pra, në arsyetimin e vendimit të gjykatës del qartësisht se kush është vrasësi, i cili është i pandehuri E.N.

12.1. Ky fakt pasqyrohet edhe në vendimin Nr. ***, datë 26.12.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër,¹⁴ ku ndër të tjera arsyetohet se: “Pasi dosja penale është kthyer për rigjykim, rezulton se ajo sërish ka qënë për gjykim ndaj të njëjtëve të pandehurve dhe me të njëjtat akuza, dhe është shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë për herë të dytë, e cila me vendimin nr. ***, datë 09.09.2016 ka deklaruar të pafajshëm të pandehurin M.P. për veprën penale të “vrasjes me dashje” parashikuar nga neni 76 i K.Penal, ka konstatuar si fajtor për vrasjen e viktimës M.Sh. të pandehurin E.N. por nuk e ka deklaruar fajtor atë për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale të akuzave të reja, si dhe ka deklaruar fajtor për moskallëzim krimi të pandehurit A.T. dhe S.P.”. Pra, nuk është i saktë konstatimi se nuk është deklaruar njeri fajtor për vrasjen e viktimës M.Sh.[...].

13. Lidhur me aryen pse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë nuk mund ta deklaronte fajtor të pandehurin E.N. për vrasjen e shtetasit M.Sh. edhe pse doli qartësisht nga provat se ai e ka kryer vrasjen, në pjesën arsyetuese të vendimit theksohet se, Gjykata nuk mund të ngrejë akuzë¹⁵ dhe nuk mund të shtonte akuzë në rastin konkret.¹⁶ Nëse do ta bënte një gjë të tillë do të cenonte dispozitat mbi akuzat e reja dhe Gjykata e Apelit Shkodër në

¹⁴ Shiko faqen 21 të këtij vendimi.

¹⁵ Në nenin 372 të K.Pr.Penale nën titullin “**Ndryshimi i akuzës**” parashikohet shprehimisht se: “I. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor fakti del ndryshe nga ç’është përshkruar në kërkesën për gjykim dhe gjykimi i tij është në kompetencën e asaj gjykate, **prokurori ndryshon akuzën dhe procedon me akuzën përkatëse.**”.

¹⁶ Në nenin 373 të K.Pr.Penale nën titullin “**Akuza për një vepër tjetër**” parashikohet shprehimisht se: “I. Kur gjatë shqyrtimit gjyqësor del një vepër penale tjetër që ka lidhje me atë që gjykohet, sipas nenit 79 gërma “b”, ose një rrethanë rënduese që nuk është përmendur në kërkesën për gjykim, prokurori i komunikon të pandehurit veprën penale ose rrethanën, por me kusht që gjykimi të mos jetë në kompetencë të një gjykate më të lartë.”.

respektim të nenit 428 pika 1 gërma “ç” të K.Pr.Penale, ku thuhet shprehimisht: “ç) prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë kur nuk janë respektuar dispozitat.....me shkeljen e dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja, si dhe në çdo rast kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit.”, do të legjitimohej për të vendosur prishjen e vendimit të shkallës së parë dhe do të ishte e detyruar ta kthente çështjen përsëri në gjykim në shkallë të parë. Arsyet pse gjykata nuk bënte dot ndryshimin e cilësimit juridik dhe ta dënonte autorin e vërtet të vrasjes që rezultoi në përfundim të gjykimit, trajtohen në paragrafët 66.1, 66.2, 66.2.1, 66.2.2, 66.2.3, 66.2.4, 66.2.5, 66.2.6, 66.2.7, 67, 67.1, 67.2, 67.3, 67.4, 67.5, 67.6 dhe 67.7 të vendimit Nr. 262, datë 09.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.[....]

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse dhe shteruese lidhur me pretendimet e denoncuesit. Mungesa e shkeljeve procedurale deduktohet edhe nga vlerësimi i bërë nga Gjykata e Apelit Shkodër, pasi ky vendim është lënë pjesërisht në fuqi prej saj – ndonëse kjo e fundit ka disponuar një ndryshim vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Trupi gjykues vlerëson se ky ndryshim vendimi nuk mund të përbëjë shkak për vlerësimin e kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit, pasi ndodhemi përpara parashikimit të nenit 72 pika 4 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “4. Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.”.

11. Denoncues shtetasi E.G. (nr. * datë 9.10.2019).** Denoncuesi ankohet për shkelje procedurale dhe gjykim në shkelje të të drejtave të palëve. Është kërkuar gjykatës së rrethit Tiranë vënia në dispozicion e praktikës lidhur me çështjen “Njohje e vendimit penal të huaj nr.*** dhe nr.*** i Rregj.përgj, datë 2.2.2001 të gjykatës së parë penale të apelit Milano, për të denuarin A.G., pas rishikimit të vendimit nr. *** datë20.5.2003 të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë.

Është kërkuar pranë Gjykatës Tiranë informacion për ecurinë e çështjes që lidhet me dononcimin e subjektit. Praktika për këtë çështje është transferuar në Gjykatën e Elbasanit, e cila e dërgoi praktikën me shkresën nr.*** datë 21.4.2021. Nga shqyrtimi i praktikës së dosjes gjyqësore rezultoi se:

- Subjekti i rivlerësimit pas caktimit si gjyqtar i vetëm për këtë çështje, më datë 19.7.2019, ka caktuar seancën gjyqësore e cila do zhvillohet më datë 9.9.2019.
- Për thirrjen e palëve më datë 8.10.2019 ka kërkuar me flet-thirrje, prezencën e avokatit A.B., të paraqitet në seancë më datë 11.10.2019. Nuk konstatohet kur ka marrë dijeni avokati për këtë seancë por koha e lënë në dispozicion duket se është e shkurtër (koha e vënë në dispozicion të palëve është caktuar kryesisht brënda 3 ditëve).
- Për thirrjen e palëve më datë 27.9.2019 ka kërkuar me atë të flet-thirrjes prezencën e avokatit E.H. dhe B.R., të paraqiten në seancë më datë 30.9.2019. Nuk konstatohet kur ka marrë dijeni avokati për këtë seancë por koha e lënë në dispozicion është 3 ditë.
- Gjykata më datë 27.9.2019 ka kërkuar shoqërimin e kërkuesit (të dënuarit) A.G. në seancën e datës 27.9.2019, si dhe e vë në dijeni se avokatët e caktuar me prokurë nga ana e tij nuk janë paraqitur në gjykim. Në këtë njoftim nuk përmendet fakti se avokati B.R. ka paraqitur raport për paaftësi të përkohshme në punë që fillon më datë 27.9.2019 deri më datë 28.9.2019. Po më datë 27.9.2019 gjykata ka vendosur të thërrasë Av. E.K. për tu njohur me aktet në rast së përfaqësuesit e të dënuarit nuk

paraqiten në gjykim dhe cakton seancën e radhës më datë 30.9.2019. Avokat E.K. ishte prezent në seancën e datës 27.9.2019. Nuk saktësohet si është caktuar ky avokat (nëse është avokat i caktuar kryesisht), si është njoftuar, pse ishte prezent dhe nëse është pyetur pala ose jo për caktimin e këtij avokati. Më datë 30.9.2019 Av. B.R. ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga kjo çështje dhe gjykata po më këtë datë pa bërë njoftimin e palës (kërkuesit të dënuar) cakton avokate kryesisht N.P. dhe cakton seancën gjyqësore të radhës në datë 2.10.2019. Më datë 2.10.2019 çelet seanca e radhës ku i dënuari ka kërkuar përfaqësimin e tij me avokat A.B. Gjykata vendos pranimin dhe vijimin e seancës në pranë të këtij avokati dhe revokon vendimin për caktimin e mbrojtjes kryesisht me av. N.P., por lejon pjesmarrjen e saj në vazhdimin e seancës. Nuk kuptohet ky vendim për prezencën në seancë të av. N.P. Gjykata pranon kërkesën e av. A.B për tu njohur me aktet dhe shtyn seancën më datë 7.10.2019. Avokati kërkon më tepër kohë për tu njohur me aktet (datë 3.10.2019 ditë e mërkurë deri 7.10.2019 ditë e hënë) por nga gjykata nuk pranohet kjo kërkesë. Në seancën e datës 7.10.2019 është paraqitur avokat A.B. i cili ka paraqitur kërkesë për shtyrje seance dhe përjashtim gjyqtari. Gjithashtu në seancën e datës 7.10.2019 është paraqitur dhe avokatja kryesisht N.P, e cila nuk ka pasur vendim gjykate pasi akti i caktimit të saj është revokuar nga gjykata. Për pjesmarrjen e saj në këtë seancë nuk është njoftuar as pala kërkuese. Në përfundim seanca gjyqësore shtyhet më datë 11.10.2019, por shkaqet e shtyerjes duken disi të cuditshme (shiko arsyetimin në proces verbalin e datë 7.10.2019). Gjithashtu ndaj subjektit të rivlerësimit rezultoi se është bërë dhe kallëzim penal.

- Më datë 21.10.2019 gjyqtar i çështjes rezulton B.Q. Nuk qartësohet si është bërë zëvendësimi gjyqtarit nga subjekti i rivlerësimit të gjyqtari B.Q.
- Nuk dihet ecuria e kërkesës për përjashtim e subjektit të rivlerësimit dhe kallëzimi penal i bërë ndaj tij për këtë çështje.

Lidhur me këtë denoncim bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016 i'u kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit, i cili lidhur me gjetjet e Komisionit pasi ka sqaruar më shkrim¹⁷ në mënyrë kronologjike dhe të detajuar ecurinë e çështje, si përfundim ka deklaruar se: [...]

16.1. Së pari, nga ana ime për periudhën që janë zhvilluar seancat gjyqësore janë respektuar me korrektësi dispozitat procedurale dhe palët kanë pasur kohën e nevojshme për t'u njohur me aktet. I dënuari dhe mbrojtësit i tij e kanë zvarritur procesin gjyqësor, ku edhe pse kanë kërkuar kohë për t'u njohur me aktet e për të marrë kopje të tyre, kurrë nuk janë paraqitur pranë sekretarisë gjyqësore për t'u njohur me to apo për t'i marrë ato. Këtu duhet të theksohet fakti se nga sekretaria gjyqësore është njoftuar me telefon mbrojtësi si të dënuarit si për fotokopjen e akteve ashtu dhe për mundësinë e paraqitjes për njohje në çdo moment. Kjo sjellje e të dënuarit A.G. dhe mbrojtësve të tij kualifikohet në ato veprime dhe mosveprime që përbën abuzim me të drejtën e mbrojtjes, për rrjedhojë nuk mund të pretendohet se nuk ka pasur mundësi për t'u mbrojtur sipas qëndrimit që ka mbajtur Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen "B. kundër Shqipërisë", Ap. Nr. ***, Vendim i Seksionit ***, datë 16.06.2005. Pra, këto sjellje janë të përjashtuara nga mbrojtja që ofron neni 6 i KEDNJ-së.

16.2. Së dyti, nga ana ime nuk është shfaqur njëanshmëri për periudhën e shqyrtimit çështjes dhe kjo rezulton jo vetëm nga procesverbalet e seancave gjyqësore por dhe nga vetë pjesa arsyetues e vendimit Nr. *** Regj.Themeltar, datë 09.10.2019 të Gjykatës së

¹⁷ Shiko prapësimet e datës 17.05.2021 mbi rezultatet paraprake të hetimit administrativeë.

*Rrethit Gjyqësor Tiranë që ka vendosur përjashtimin tim, ku ndër të tjera thuhet se: “Gjykata, si shqyrtoi në tërësi dosjen penale me Nr. *** Regj.Them., datë regjistrimi 08.07.2019, pasi analizoi pretendimet e palëve, në vështrim të parashikimeve të mishëruara në dispozitat ligjore përkatëse të K.Pr.Penale, konstaton se gjyqtari nuk ka treguar njëanshmëri në punën e tij,....”.*

16.3. Së treti, paraqitja e kallëzimit ndaj meje është bërë vetëm dhe vetëm për të më përjashtuar mua nga gjykimi i çështjes dhe për të intimiduar trupin gjykues. Tek unë djali i ankuesit përdori kallëzimin penal për të më përjashtuar, ndërsa tek gjyqtarët e tjerë krijoj situatën e përjashtimit duke përzgjedhur si mbrojtës familjarë të afërt të gjyqtarit. Pra, qëllimi i të dënuarit është përdorja e çdo mjeti për të përjashtuar gjyqtarit me qëllim përzgjedhjen e një magjistrati tjetër, gjë që nuk kontibon në zhvillimin e një procesi brenda një afati të arsyeshëm. Ju bëjë me dije se gjatë karrierës time si gjyqtar nuk e kam bërë, nuk e bëjë dhe nuk do të bëjë kërkesa për dorëheqje nga gjykimi i një çështje penale me qëllim që të krijohen përfitime të padrejta për palët dhe të tretët ose që synojnë shmangien e detyrimit ligjor për shqyrtimin e çështjes apo të krijojë mundësinë që çështja të shqyrtohet nga një magjistrat tjetër, rrethana këto që passjellin përgjegjësi disiplinore për gjyqtarin në kuptim të nenit 102 pika 1 gërma “b”, pika “ii” të Ligjit Nr. 96/2016 “PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”.

16.4. Së katërti, çështja në ngarkim të të dënuarit A.B. ndodhet ende në procesi gjykimi në shkallë të parë, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndodhur në këto kushte, përderisa nuk ka një vendim përfundimtar për këtë çështje çmoj se kjo ankesë nuk mund të jetë objekt vlerësimi në kuptim të nenit E të Kushtetutës, ku ndër të tjera thuhet se: “Vlerësimi i aftësisë nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.”. Pra, kjo çështje është në proces shqyrtimi në shkallë të parë.[....]

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime bindëse dhe shteruese lidhur me pretendimet e denoncuesit. Nuk konstatohet që në veprimtarinë e subjektit të rivlerësimit të jenë kryer shkelje të normave procedurale. Përkundrazi nga ana e këtij të fundit janë bërë të gjitha përpjekjet për ta përfunduar gjykimin brenda një afatit të arsyeshëm dhe për t’i garantuar djalit të denoncuesit të gjitha të drejtat që rrejdhin nga procesi penal.

12. Kallëzim penal nga shtetasi B.I. (nr.* datë 11.10.2019).** Nuk paraqiten elementet e një denoncimi por të një kallëzimi penal. Kjo ankesë është shqyrtuar dhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili me vendimin Nr. *** Prot., datë 20.11.2020 ka vendosur arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi B.I.” ndaj subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, është vendosur mosfillimi i procedimit penal, i cili është lënë në fuqi dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

13. Denoncim i shtetasit K.Y. (nr. * datë 1.11.2018).** Denoncon subjektin e rivlerësimit për vendim të padrejtë dhe mungesë profesionalizmi. Denoncuesi ka paraqitur vendim gjyqësor të datës 21.9.2018. Nuk konstatohen problematika nga ky vendim penal ku subjekti i rivlerësimit rezultoi si anëtar trupe.

Në përfundim:

Mbështetur në raportin e vlerësimit profesional për çështjet e shortuara dhe denoncimet e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është efecient dhe efektiv në masë të pranueshme.

Në vlerësimin lidhur me aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Bani, nuk rezultoi të jetë gjetur ndonjë problem mjaftueshëm i rëndësishëm që do çonte në një vlerësim aftësish profesionale më pak ose ndryshe nga ai “i përshtatshëm” sipas nenit 44/a, të ligjit nr. 84/2016.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësimit të figurës dhe vlerësimit profesional, si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave, Komisioni, arrin në përfundimin se:

Për vlerësimin e pasurisë

Bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit subjekti ka kryer deklaram të saktë të pasurive dhe interesave private, si dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Ai nuk është përpjekur të fshehë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi të tij. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Erjon Bani, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk vërtetohen shkaqet që neni D i Kushtetutës, i ka parashikuar të tilla që zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit justifikon plotësisht me burime të ligjshme krijimin e pasurive (gjendjet e likuiditeteve në llogari bankare dhe ato cash), dhe kryerjen shpenzimeve përgjatë gjithë periudhës që ka ushtruar funksionin si gjyqtar.

Për vlerësimin e figurës

Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Bani, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Për vlerësimin e aftësive profesionale

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues, pas vlerësimit të parashtrimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti dhe propozimit të relatorit të çështjes arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues, në kuptim të germës c, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit, z. Erjon Bani, ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “a”, pika 1, të nenit 58, dhe të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 , “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, **z. Erjon Bani**, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 24.5.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Roland ILIA
Relator

Etleda ÇIFTJA
Anëtare

Ertugena Sokoli
Sekretare gjyqësore